

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5557  
E enjte, 23 gusht 2018  
çmimi 0.40 €

## Kosova po i përgjigjet ofensivës diplomatike serbe

Republika e Kosovës po i kundërpërgjigjet shpejt dhe në mënyrë të duhur ofensivës diplomatike serbe për revokimin e njohjeve. Kështu ka thënë për gazetën "Epoka e re" zëvendësministria e Punëve të Jashtme, Rejhan Vuniqi | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

#### PO E THE TË VËRTETËN, ARMIQTË I KE NË DERË F. 11

Shkruan: Jakup KRASNIQI



#### NGA TOPLICA NË PRIZREN, IVICA DAÇIQI, PINJOLL I NJË FAMILJEJE ME TRADITË POLICORE F. 11

Shkruan: Ramadan AVDIU



#### ÇFARË THONË DOKUMENTET SERBE PËR DITËLINDJEN E ADEM JASHARIT F. 12-13



Bedri ISLAMI

#### QEVERIA JEP 300 MIJË EURO PËR DELEGATËT E VITIT 1990 F. 9

### EKONOMI

#### PËR BIZNESET, VETËM REGJISTRIMI ËSHTË I LEHTË F. 9

### SPORT

#### HAJDARI: DRENICA, MËSIM PËR LLAPIN F. 18

#### GREZDA: DUA TË JEM SA MË PARË GATI PËR SHOQIPËRINË F. 18

F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", RAGMI MUSTAFA | FAQE 4-5

## Nuk do të heqim dorë nga bashkimi me Kosovën

Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Ragmi Mustafa, ka shprehur optimizëm se kërkesa e shqiptarëve të Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën do të bëhet pjesë e takimit të radhës në kuadër të dialogut të Brukselit. Pavarësisht prej reagimeve të fuqive të mëdha, ai e ka quaj-

tur të realizueshme kërkesën e shqiptarëve të Luginës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mustafa ka thënë se bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën në asnjë mënyrë nuk do të ketë efekt domino në vendet e tjera në Ballkanin Perëndimor. Në këtë kontekst, ai ka theksuar se nëse

dy vendet fqinjë arrijnë marrëveshje paqësore nuk mund të kundërshtohet nga askush korrigjimi i kufirit, rrjedhimisht edhe bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën. Sipas Mustafës, Lugina e Preshevës asnjëherë nuk do të heqë dorë nga kërkesa për të qenë pjesë integrale e Republikës së Kosovës

CAKTOHET PROKURORI I RI PËR VAZHDIMIN E HETIMEVE PËR LISTAT E VETERANËVE TË UÇK-së

## 19 mijë veteranëve pritet t'u ndalen pensionet

Pas dorëheqjes së prokurorit Elez Blakaj, kryeparlamentari Kadri Veseli ka bërë me dije se i ka shkruar letër Këshillit Prokurorial të Kosovës në lidhje me hetimin për listat e veteranëve të UÇK-së. Ai ka thënë se në procesin e verifikimit të statusit të veteranëve të UÇK-së janë bërë manipulime. Edhe Kryesia e OVL-UÇK-së i ka bërë thirrje Prokurorisë së shtetit që kësaj çështje t'i shkojë deri në fund. Ndërkaq kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka paralajmëruar se pas ngritjes së aktakuzës do të merret vendim për ngritjen e masës së përkohshme që veteranëve të rrejtshëm t'u ndërpriten pagesat | FAQE 7



## Bajram Rexhepi do të mbahet mend për kulturën e lartë demokratike

FAQE 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Çurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Shqiptarët po lënë shtetësinë, rritet numri i rezidentëve të huaj

TIRANË, 22 GUSHT - Numri i të huajve që kërkojnë të qëndrojnë në Shqipëri është rritur 3 për qind në krahasim me vitin e shkuar, duke prekur numrin e 12 906 personave. Në total për vitin 2017 janë 8 395 meshkuj dhe 4 511 femra. Prej tyre, rreth 60 për qind janë me

originë nga Evropa, teksa 316 kanë mundur ta marrin shtetësinë shqiptare përgjatë vitit të shkuar.

Situata mbetet shqetësuese me personat që kërkojnë ta lënë shtetësinë shqiptare. Në vitin 2017 rezultojnë 651 persona të cilët kanë hequr dorë

nga shtetësia, duke pësuar rritje me 32.9 për qind.

Instat raporton se në total janë 1 049 persona që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme. Klandestinët vijnë kryesisht nga Siria, Algjeria dhe Libia. Por prej tyre, vetëm 309 kanë kërkuar azil, duke shënuar rritje

je rreth 30 për qind krahasuar me një vit më parë. Duke analizuar vendin e originës së azilkërkuësve në Shqipëri, shumicën e rasteve e përbëjnë ato me originë nga Siria me 111 persona, me originë nga Algjeria 61 dhe nga Afganistani 29 azilkërkuës.



## Hooper: Populli i Kosovës ta mendojë me shumë kujdes korigjimin e kufijve

Duke komentuar idenë e presidentit Hashim Thaçi për korigjim të kufijve me Serbinë, ish-diplomati amerikan dhe njohësi i zhvillimeve në Ballkan, James Hooper, ka porositur që populli i Kosovës ta shohë këtë çështje në perspektivë dhe në veçanti t'u qaset këtyre diskutimeve 'me kokë të ftohtë', me gjakftohtësi dhe pa emocione

PRISHTINË, 22 GUSHT - "Populli i Kosovës duhet ta kuptojë se Shtetet e Bashkuara të ditës së sotme nuk janë Shtetet e Bashkuara të viteve 1998, 1999, 2000 e kështu me radhë. Situata ka ndryshuar", ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ish-diplomati amerikan dhe njohësi i zhvillimeve në Ballkan, James Hooper.

I pyetur rreth idesë se presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, për ndryshim të kufijve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ai ka thënë se populli i Kosovës duhet ta shohë këtë çështje në perspektivë. "Dua të porosis fillimisht që populli i Kosovës ta shohë këtë çështje në perspektivë, në veçanti t'u qaset këtyre diskutimeve 'me kokë të ftohtë', me gjakftohtësi dhe pa emocione. Mendoj se është shumë e rëndësishme ta shohim rezultatin e këtyre deklaratave. Ja pse! E gjithë kjo është projektuar si debat për kufijtë, qoftë përcaktim i kufijve, korigjim apo diçka tjetër. Mirëpo e gjithë kjo, në fakt, përbën diskutim për një marrëveshje

je që do ta ndryshojë marrëdhënien e Kosovës me Shtetet e Bashkuara dhe Evropën dhe ndryshim në aspektin pozitiv, pra do t'i përmirësojë lidhjet. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Prandaj unë vërtet dua të përçoj këtë mesazh që populli i Kosovës duhet ta mendojë mirë këtë proces, me shumë kujdes, sepse po bisedohet për marrëdhënien e ardhshme që do të ketë me ShBA-në dhe Evropën", ka thënë Hooper.

Në pyetjen se Londra dhe Berlina e kanë thënë qartë se janë kundër çfarëdo lëvizjeje të kufijve, Uashingtoni thuhet ta ketë zbutur qëndrimin paksa, me thirrjen që ua ka bërë të dyja palëve për fleksibilitet dhe kreativitet, Hooper ka dhënë këtë përgjigje: "Mendoj se Uashingtoni me siguri ka një perspektivë ndryshe në këtë çështje, për dallim nga Berlina dhe Londra. Populli i Kosovës duhet ta studiojë këtë dhe të kuptojë se Shtetet e Bashkuara të ditës së sotme nuk janë Shtetet e



Bashkuara të viteve 1998, 1999, 2000 e kështu me radhë. Situata ka ndryshuar. Siç e shoh unë, kjo e vë në pah vështirësinë e

Kosovës në të qenit shtet i vogël në një rajon jostabil. Është shumë e rrezikshme në këto ditë për Kosovën që të niset drejt se

ardhmes derisa është fqinje me një Serbi armiqësore. Zbutja e armiqësisë së Serbisë është e rëndësishme për Kosovën. Mbajeni në mend se sa i përket rajonit, rruga nëpër të cilën është nisur Kosova është e mbushur me plot gropa. Kosovës i duhet gjithmonë një 'ngasës' i mirë. Në këtë aspekt varet nëse populli i Kosovës i beson udhëheqësisë së vet. Ndonëse e di se ka pasur kritika për politikën e brendshme, në rastin e presidentit Thaçi, mendoj se ai i ka ofruar Kosovës udhëheqësi të mirë në çështje ndërkombëtare, andaj populli i Kosovës duhet ta ketë parasysh këtë gjë".

## Serbia pranon dy avionët e tipit MiG-29 të blerë nga Rusia

Beograd, 22 gusht - Serbia ka pranuar dërgesën e dy avionëve luftarakë rusë të tipit MiG-29. Kjo dërgesë është e para, pasi Beogradi ka arritur një marrëveshje me Moskën për të blerë gjashtë avionë. Presidenti serb Aleksandar Vuçiq ishte i pranishëm në ceremoninë e pranimit të këtyre avionëve që u mbajt në aeroportin ushtarak në Beograd. Në total, Beogradi do t'i paguajë Moskës për riparim dhe mirëmbajtjen e



gjashtë avionëve rreth 185 milionë euro. Të prodhuar më 1989 dhe 1991, avionët e blerë nga

Rusia janë më të rinj se MiG-ët që aktualisht Serbia, të cilët i ka blerë më 1987.

## "Facebook"-u dhe "Twitter"-i mbyllin llogari të lidhura me fushata të Ruisë dhe Iranit

CALIFORNIA, 22 GUSHT - Rrjetet sociale "Facebook" dhe "Twitter" kanë njoftuar për pezullimin apo mbylljen e llogarive që kanë qenë të lidhura me Iranin apo Rusinë për shkak të qasjes së tyre "manipuluese". Më shumë se 650 llogari dhe grupe në "Facebook" është thënë të jenë identifikuar si "mashtroese", sipas shefit ekzekutiv të kësaj kompanie, Mark Zuckerberg. "Twitter" në anën tjetër ka thënë

se ka pezulluar 284 llogari që duket se kanë qenë të lidhura me Iranin. Këto njoftime vijnë vetëm një ditë pasi kompania "Microsoft" ka thënë se ka penguar disa sulme kibernetike ruse kundër grupeve konservatore amerikane.

Të martën "Facebook" ka njoftuar se ka zbuluar disa llogari të cilat kanë publikuar material të pavërtetë, të lidhur me fushatat nga Irani dhe Rusia. "Ne kemi

ndaluar këtë lloj të sjelljes, sepse ne dëshirojmë që njerëzit të jenë në gjendje t'u besojnë lidhjeve që krijojnë", ka theksuar kompania në një deklaratë.

Pavarësisht se hetimi ende është duke vazhduar, kompania ka shtuar se fushata ka shënjestruar njerëz me interesa të ndryshme në Lindje të Mesme, Amerikën Latine, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.





Diplomacia serbe vazhdon të kërkojë prej shteteve që e kanë njohur Republikën e Kosovës ta rishqyrtojnë këtë akt

## Kosova po i përgjigjet ofensivës diplomatike serbe

Republika e Kosovës po i kundërpërgjigjet shpejt dhe në mënyrë të duhur ofensivës diplomatike serbe për revokimin e njohjeve. Kështu ka thënë për gazetën "Epoka e re" zëvendësministria e Punëve të Jashtme, Rejhan Vuniqi. Kurse profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka thënë për gazetën se diplomacia e Kosovës duhet të jetë më aktive dhe më e koordinuar në këtë drejtim. Para dy dite shefi i diplomacisë serbe, Ivica Daciq, ka kërkuar sërish nga homologia e tij e Ganës që ta rishikojë vendimin për njohjen e Kosovës si shtet



**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 22 GUSHT** - Serbia nuk po ndalet së komunikuar me vendet e tjera për çështjen e Kosovës, derisa Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës ka bërë me dije se në mënyrën e duhur po reagon ndaj kësaj ofensive diplomatike serbe. Sërish shefi i diplomacisë serbe, Ivica Daciq, ka kërkuar nga Gana ta rishikojë vendimin për njohjen e Republikës së Kosovës si shtet.

Mirëpo zëvendësministria e Punëve të Jashtme, Rejhan Vuniqi, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re", se këto kërkesa të Serbisë ndaj disa vendeve nuk po kanë sukses. "Procesi i njohjes së Kosovës është projekti më i suksesshëm i politikës së jashtme të Kosovës. Kjo nuk është diçka e mirëpritur nga Serbia dhe duke sulmuar këtë proces, Serbia përpjetat vazhdojë politikën e vjetër të njohur për ta kundërshtuar pavarësinë e Kosovës. Kosova është e pavarur dhe e njohur nga 116 vende dhe, si e tillë, do të

vazhdojë ta rrisë angazhimin dypalësh me të gjithë anëtarët e bashkësisë ndërkombëtare. Ministria e Punëve të Jashtme ka reaguar shpejt dhe me sukses në përpjekjet e Serbisë për ta revokuar njohjen e Kosovës", ka thënë Vuniqi.

Ajo ka treguar edhe për hapat konkretë që po i ndërmer diplomacia e Kosovës për t'iu kundërpërgjigjur Serbisë. "Ne po komunikojmë me të gjitha vendet që e kanë njohur Kosovën duke forcuar bashkëpunimin tonë dypalësh, duke emëruar ambasadorët jorezidentë dhe hapjen e misioneve të reja diplomatike për ta forcuar praninë e Kosovës në të gjitha anët e botës etj. Duhet të jetë e qartë se nuk ka revokim të njohjes në të drejtën ndërkombëtare dhe praktikën diplomatike. Nuk mund të shkoni në një vend tjetër dhe të thoni se nuk njihni një vend tjetër. Është krejtësisht jodiplomatike. Serbia po abuzon me gjendjen ekonomike të disa vendeve duke ofruar ndihmë ushtarake, stimule financiare, heqjen e vizave

etj", ka thënë ajo, duke treguar se për këto veprime Kosova është ankuar edhe në BE. "Ne kemi shprehur shqetësimin tonë se Serbia si një vend kandidat i BE-së po e përdor diplomacinë e dollarit për të marrë disa nota verbale të rreme/falsifikuar. Në një formulim tjetër, ky është korrupsion. Në të njëjtën kohë po shkelet rregulli i Shengenit me të cilin Serbia është e detyruar të mbetet e angazhuar në listën e bardhë të Shengenit. Ajo po heq regjimin e vizave për vendet që potencialisht në një kohë krize migrimi në Evropë mund të kontribuojnë në përdorimin e Ballkanit si një zonë transiti. Ky është një shqetësim për Kosovën dhe Bashkimi Evropian duhet të jetë i shqetësuar se kriteret e tij bazë nuk respektohen nga vendet e tjera të rajonit. Dhe, ne i kemi ngritur këto shqetësime në Bruksel", është shprehur Vuniqi.

Kurse profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe njohësi i proceseve politike, Ibrahim Gashi, ka

thënë se diplomacia e Kosovës duhet të jetë e kujdesshme në këtë drejtim. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se diplomacia e Kosovës duhet të jetë më aktive, më e koordinuar dhe më e efektshme ndaj ofensivës serbe kundër njohjes së pavarësisë së shtetit të Kosovës. "Serbia që nga 17 shkurti i vitit 2008 nuk ka reshtur së punuari për minimin e pavarësisë së Kosovës, e sidomos në planin ndërkombëtar. Fatmirësisht, efektet e këtij lobimi serb jo gjithmonë kanë arritur efektet e tyre, edhe për faktin e mbështetjes së madhe të diplomacisë së shteteve të fuqishme mike të Kosovës, por edhe falë aktiviteteve të diplomacisë së Kosovës. Kjo e fundit ka mundur dhe mund të jetë më aktive, më e koordinuar dhe më e efektshme. Duhet më shumë aktivitete të diplomacisë zyrtare të shtetit të Kosovës, të diplomacisë parlamentare, edhe të diplomacisë publike", ka thënë Gashi. Para dy dite ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Ivica Daciq, ka

kërkuar nga ministria e Punëve të Jashtme dhe e Integritimit Rajonal të Ganës, Shirli Boçveç, e cila ka vizituar Beogradin, që ky vend ta revokojë njohjen për Kosovën. "Nuk dëshirojmë të bëjmë presion dhe Kosova as që është tema kryesore e atyre për të cilat po flasim. Ky është vendimi i tyre dhe ne do të donim që edhe një herë ta analizojnë situatën, e cila tash është shumë më ndryshe, sepse po hulumtohet për zgjidhjet dhe po zhvillohet dialogu. Do të donim të rishqyrtohet vendimi të cilin e ka sjellë administrata e mëparshme", ka theksuar Daciq.

Ndërsa kryetari i Parlamentit të Ganës, Ajron Majkl Okvaje, gjatë vizitës në Beograd në muajin maj kishte deklaruar se Gana do ta shqyrtojë çështjen e pranimit të pavarësisë së Kosovës. Por, më 8 qershor, ambasadorja e emëruar e Ganës në Prishtinë, Salma Frances Mancell-Egalla, ia ka dorëzuar letërën kredenciale ministrit të Punëve të Jashtme të Qeverisë së Kosovës, Behgjet Pacolli.

## Gjermania konfirmon përkrahjen në proceset euroatlantike për Kosovën

**PRISHTINË, 22 GUSHT (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të mërkurën në takim komisionarin parlamentar për Forcat e Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë, Hans-Peter Bartels. Haradinaj e ka njoftuar komisionarin Bartels për progresin e Kosovës dhe për prioritetet e Qeverisë, për zhvillimin ekonomik si dhe për forcimin e sundimit të rendit dhe të ligjit, duke e falënderuar shtetin gjerman për kontributin e gjithanshëm në shtetndërtimin e Kosovës.

Gjatë takimit kryeministri Haradinaj e ka vlerësuar rolin historik të forcave ushtarake gjermane që kanë shërbyer për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore jashtë Gjermanisë, në



kuadër të misionit paqeruajtës të KFOR-it në Kosovë. "Gjermania është një prej donatorëve kryesorë në Kosovë që nga viti 1999

dhe vazhdon të jetë përkrahëse në procese të rëndësishme për vendin dhe për këtë u jemi mirënjohës. Kjo u dëshmuar edhe

me shndërrimin e kampit ushtarak në park inovativ dhe trajnues në Prizren, mundësi e mirë për rritjen e zhvillimit

ekonomik", ka deklaruar Haradinaj, duke kërkuar mbështetjen e mëtutjeshme të shtetit gjerman për proceset integruese dhe euroatlantike të Kosovës.

Në këtë takim u bisedua edhe për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, për rolin e Gjermanisë në procesin e dialogut, liberalizimin e vizave, anëtarësimin e Kosovës në organizatën të rëndësishme ndërkombëtare, me theks të veçantë në Interpol. Kurse komisionari parlamentar për Forcat e Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë, Hans-Peter Bartels, duke vlerësuar progresin e Kosovës, ka deklaruar se Gjermania do të vazhdojë ta përkrahë Kosovën në rrugën e vet euroatlantike.



Flet për "Epokën e re", Ragmi Mustafa

# Nuk do të heqim dorë ng

## - Kërkesa e Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën është e realizueshme



Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Ragmi Mustafa, ka shprehur optimizëm se kërkesa e shqiptarëve të Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën do të bëhet pjesë e takimit të radhës në kuadër të dialogut të Brukselit. Pavarësisht prej reagimeve të fuqive të mëdha, ai e ka quajtur të realizueshme kërkesën e shqiptarëve të Luginës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mustafa ka thënë se bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën në asnjë mënyrë nuk do të ketë efekt domino në vendet e tjera në Ballkanin Perëndimor. Në këtë kontekst, ai ka theksuar se nëse dy vendet fqinjë arrijnë marrëveshje paqësore nuk mund të kundërshtohet nga askush korrigjimi i kufirit, rrjedhimisht edhe bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën. Sipas Mustafës, Lugina e Preshevës asnjëherë nuk do të heqë dorë nga kërkesa për të qenë pjesë integrale e Republikës së Kosovës

asnjëherë nuk do të heqë dorë nga kërkesa për të qenë pjesë integrale e Republikës së Kosovës. Proceset politike nuk mbyllen këtu dhe përgjithmonë. Edhe në të ardhmen do të kërkojmë të jemi pjesë integrale e Kosovës, atje ku na flenë zemra dhe trupi. Askush të mos mendojë se shqiptarët e Luginës do të bëjnë amin me këtë rast dhe do të heqin dorë nga kërkesa e tyre legjitime për t'u bashkuar me Kosovën", ka theksuar Mustafa. Ai ka shprehur optimizëm se kërkesa e shqiptarëve të Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën do të bëhet pjesë e takimit të radhës në kuadër të dialogut të Brukselit.

Luginës së Preshevës daton nga referendumi i 1 dhe 2 marsit të vitit 1992, ku mbi 97 për qind janë shprehur për autonomi politike territoriale me të drejtë bashkimi me Kosovën. Bazuar në këtë, i gjithë lidershipi i Luginës së Preshevës ka kërkuar nga presidenti i Kosovës që kërkesa e shqiptarëve të Luginës të jetë pjesë e tryezës së ardhshme në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Presidenti Thaçi ka marrë një obligim dhe një barrë jo të lehtë për ta proceduar kërkesën tonë në takimin e radhës në Bruksel.

**"Epoka e re":** Jeni optimist se kjo kërkesë do të pranohet nga Serbia si palë negociuese? Në rast se po, përfaqësuesit e Luginës do të jenë të pranishëm në takimet e ardhshme në Bruksel?

**Mustafa:** Kemi kërkuar nga autoritetet e Republikës së Kosovës, Presidenca, Kuvendi dhe Qeveria, që të merren seriozisht

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 22 GUSHT - Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Ragmi Mustafa, ka thënë të mërkurën se, pavarësisht prej reagimeve të fuqive të mëdha, kërkesa e shqiptarëve të Luginës së Preshevës për bashkim me shtetin e Kosovës është e realizueshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re",

ai ka vlerësuar se bashkimi i Luginës me Kosovën në asnjë mënyrë nuk do të ketë efekt domino në vendet e tjera në Ballkanin Perëndimor. "Këto deklarime përçojnë vetëm një mesazh se në mes të dy shteteve nuk ka korrigjim të kufirit njëanshëm. Në këtë mënyrë duhet të përkthehet mesazhi i zyrtarëve evropianë dhe amerikanë. Korrigjimi i kufirit në mënyrë të dyanshme do të mbështet nga të

gjithë, përfshirë këtu edhe BE-në dhe ShBA-në. Në rastin konkret nëse dy vendet fqinjë arrijnë marrëveshje paqësore nuk mund të kundërshtohet nga askush korrigjimi i kufirit, rrjedhimisht edhe bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën", është shprehur Mustafa, duke shtuar se shqiptarët e Luginës së Preshevës asnjëherë nuk do të heqin dorë nga bashkimi me Republikën e Kosovës. "Lugina e Preshevës

**"Epoka e re":** Z. Mustafa, në pjesën e parë të shtatorit është paraparë të mbahet takimi i radhës në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi. Prisni që çështja e Luginës së Preshevës të jetë pjesë e këtij takimi?

**Mustafa:** Kërkesa e shqiptarëve të



# a bashkimi me Kosovën



me zgjidhjen e statusit politik të shqiptarëve në Luginë të Preshevës dhe nuk është e domosdoshme që autoritetet e Luginës të jenë pjesë e takimeve, prandaj do t'u besojmë institucioneve të Kosovës. Shqiptarët e Luginës së Preshevës e konsiderojnë vetën pjesë integrale të territorit të Kosovës edhe pse ende jemi nën okupimin serb. Besoj se çështja e Preshevës do të bëhet pjesë e dialogut Kosovë - Serbi, sidomos në takimin e parë në fillim të shtatorit. Jemi duke pritur fillimisht reagimin e Serbisë, të Bashkimit Evropian si ndërmjetësues i bisedimeve dhe të ShBA-së si garantuese e çfarëdo marrëveshje që arrihet ndërmjet dy vendeve.

**"Epoka e re":** Në Kosovë ka pasur reagime se po manipulohet me çështjen e Luginës dhe se nuk do të trajtohet seriozisht kërkesa e shqiptarëve.

**Mustafa:** Nuk besoj se dikush mund të luajë me Luginën dhe popullin e saj të shumëvujtur, sepse kjo më së paku do t'i shkojë për shtati presidentit, parlamentit, qeverisë apo partive politike. Këtu nuk ka vend për manipulime sepse asnjë gjë të keqe nuk i bëjnë Kosovës shqiptarët e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Përkundrazi, kemi dhënë kontributin tonë në të gjitha periudhat nëpër të cilat ka kaluar Kosova dhe duke i pasur parasysh këto, autoritetet e Kosovës nuk mund të luajnë me ndjenjat dhe fatin e shqiptarëve duke lënë Luginën e Preshevës jashtë territorit integral të Kosovës.

**"Epoka e re":** Do të sillte efekte destabilizuese në rajon bashkimi i Luginës me Kosovën?

**Mustafa:** Në asnjë mënyrë nuk do të ketë efekt domino në vendet e tjera në Ballkanin Perëndimor bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovës, sepse kjo do të jetë në kuadër të marrëveshjes së arritur në mes të dy shteteve. Në momentin kur dy vende do të merren vesh për një çështje nuk ka arsye të reflektojë te vendet e tjera. Në këtë drejtim uroj që të arrihet një marrëveshje paqësore dhe pas luftërave të përgjakshme dy vendet të pajtohen.

**"Epoka e re":** Ideja për korrigjimin e kufirit me Serbisë si dhe mundësia e bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën është kundërshtuar nga vendet e fuqishme që e kanë përkrahur pavarësimin e Kosovës. Sipas ShBA-së, Gjermanisë dhe Britanisë së Madhe, nuk mund të ketë ndryshim të kufijve në Ballkanin Perëndimor. Këto reagime kanë zbehur shpresat e shqiptarëve të asaj pjese për realizim të kërkesës së tyre?

**Mustafa:** Këto deklarime përçojnë vetëm një mesazh se në mes të dy shteteve: nuk ka korrigjim të kufirit njëanshëm. Në këtë mënyrë duhet të përkthehet mesazhi i zyrtarëve evropianë dhe amerikanë. Korrigjimi i kufirit në mënyrë të dyanshme do të mbështet nga të gjithë, përfshirë këtu edhe BE-në dhe ShBA-në. Në rastin konkret nëse dy vendet fqinjë arrijnë marrëveshje paqësore nuk mund të kundërshtohet nga askush korrigjimi i kufirit, rrjedhimisht edhe bashkimi i Luginës së Preshevës

me Kosovën.

**"Epoka e re":** Do të pranohet nga Serbia kërkesa e shqiptarëve që Kosovës t'i bashkohet Lugina e Preshevës, kurse Serbia të mos përfitojë asgjë?

**Mustafa:** Në këtë fazë Lugina e Preshevës është duke kërkuar bashkimin me Kosovën, pra korrigjimin e kufirit të vendosur padrejtësisht ndaj shqiptarëve. Se cili do të jetë epilogu i këtij procesi do të shihet pas takimit që do të mbahet në muajin tjetër në mes të dy presidentëve. Por deri më tani nuk ka një reagim kundërshtues prej Beogradit zyrtar lidhur me këtë çështje.

**"Epoka e re":** Në rrethanat aktuale, e shihni të realizueshme kërkesën e shqiptarëve të luginës për t'iu bashkuar Kosovës?

**Mustafa:** Absolutisht kërkesa e shqiptarëve të Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën është e realizueshme sepse kufijtë janë vendosur padrejtësisht, pa dëshirën e shqiptarëve dhe po mbahen edhe sot pa dëshirën e tyre. Serbia nuk është e gatshme t'ua ofrojë të drejtat elementare shqiptarëve në Luginë, prandaj duhet të largohet përfundimisht nga Lugina siç u largua dhe hoqi dorë nga Kosova në vitin 1999.

**"Epoka e re":** Para se të flitet për korrigjimin e kufirit është përfolur shumë çështja e shkëmbimit të territorit, pra Kosova ta marrë Luginën, kurse Serbia veriu. Do të pranoni që të bëheni pjesë e Kosovës në këmbim të veriut?

**Mustafa:** Për këtë vendosin

autoritetet shtetërore të Kosovës dhe ne nuk do të jemi kurrë element destabilizues në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ne do t'i mbështesim marrëveshjet e arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por gjithmonë me kërkesën që Lugina të mos mbetet jashtë territorit integral të Kosovës.

**"Epoka e re":** Z. Mustafa, cili do të jetë reagimi i Luginës së Preshevës nëse kërkesa e shqiptarëve për bashkim me Kosovën nuk do të bëhet pjesë e dialogut dhe, si e tillë, do të mbetet e perealizueshme?

**Mustafa:** Lugina e Preshevës asnjëherë nuk do të heqë dorë nga kërkesa për të qenë pjesë integrale e Republikës së Kosovës. Proceset politike nuk mbyllen këtu dhe përgjithmonë. Edhe në të ardhmen do të kërkojmë që të jemi pjesë integrale e Kosovës, atje ku na flenë zemra dhe trupi. Askush të mos mendojë se shqiptarët e Luginës do të bëjnë amin me këtë rast dhe do të heqin dorë nga kërkesa e tyre legjitime për t'u bashkuar me Kosovën. Nëse Kosova e Serbia bëhen pjesë e BE-së, ne sërish do ta kërkojmë realizimin e kërkesës tonë për t'u bërë pjesë integrale e Kosovës. Edhe përkundrazi asaj që në heshtje do të pranojmë çfarëdo marrëveshje që do të arrihet në mes të Kosovës dhe Serbisë, por asnjëherë nuk do të heqim dorë nga kërkesa për bashkim me Kosovën. Ky do të jetë amanet gjeneratë pas gjeneratë dhe brez pas brezi i shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Ky ka qenë edhe amanet i të parëve tanë.

## Haradinaj: Elez Blakaj e ka vënë në pikëpyetje heqjen e vizave

PRISHTINË, 22 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka quajtur sërish hajn dhe joprofesionist prokurorin e dorëhequr, Elez Blakaj, i cili ka hetuar listat e veteranëve të UÇK-së. Kryeministri në një konferencë për medie pas mbledhjes së Qeverisë ka thënë se Blakaj e ka vënë në pikëpyetje heqjen e vizave për Kosovën, derisa dorëheqjen e tij e ka vlerësuar thikë pas shpinës ndaj punës që është bërë. "Ju siguroj, unë jam kundër që ai që nuk është veteran të jetë në lista, por

ai është hajn (Elez Blakaj). Atij njeriu krejt kushtet ia kemi dhënë për punë dhe nuk ka pasur kërcënim. Ajo çfarë ka thënë është rrenë, është mashtrim. Me ditë të tëra kanë ndenjur në zyrën time prokurorët. E ka quajtur fajin me spekulime. Ky është hajn dhe joprofesionist. Përmes zhurmave publike, si Tomë Gashi, s'mund të bëhesh profesionist. Ky hajn na ka vënë në pikëpyetje për ta marrë liberalizimin e vizave. Është një thikë pas shpinës që ia ka bërë punës këtu", ka thënë Haradinaj.





## SBASHK-u: Në arsim të pensionohen para kohe punëtorët me sëmundje të rënda

PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Kosovës (SBASHK) nëpërmjet një komunikate për media i është drejtuar Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe institucioneve të Kosovës nga të cilat kërkohet krijimin e mekanizmave ligjorë për pensionimin para kohe të punëtorëve arsimorë me sëmundje të rënda. "Nëse institucionet do ta kundërshtojnë angazhimin për një ligj lidhur me uljen e moshës së pensionimit për të gjithë të punësuarit në arsimin parauniversitar, me arsyetimin se do të jetë numër i madh i atyre që vullnetarisht do ta shfrytëzojnë këtë të drejtë dhe se kërkohen shumë mjete buxhetore, atëherë MASHT-i do të duhej të krijonte mekanizma ligjorë për pensionimin e punëtorëve arsimorë me sëmundje të rënda", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut.

SBASHK-u ka theksuar se është për t'u përhëndetur angazhimi lidhur me Ligjin për pensionim të parakohshëm të zyrtarëve policorë por, sipas këtij institucioni, është mirë që edhe

MASHT-i të angazhohet dhe të përgatisë një ligj për uljen e moshës së pensionimit për punëtorët në arsimin parauniversitar. "Këtë të drejtë të punësuarit në këtë sektor do ta shfrytëzojnë bazuar në vullnetin e tyre apo në gjendjen shëndetësore. Nëse institucionet do ta kundërshtojnë e pengojnë përpjekjen e MASHT-it për një ligj lidhur me uljen e moshës së pensionimit për të gjithë të punësuarit në arsimin parauniversitar, me arsyetimin se do të jetë numër i madh i atyre që vullnetarisht do ta shfrytëzojnë këtë të drejtë dhe



se kërkohen shumë mjete buxhetore, atëherë Ministria e Arsimit do të duhej të krijonte mekanizma ligjorë për pen-

sionimin e punëtorëve arsimorë me sëmundje të rënda", është theksuar në komunikatën e SBASHK-ut.

## Ministri Ismaili kërkon disiplinë nga drejtorët e klinikave të QKUK-së



EPOKA  
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 22 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka takuar të mërkurën drejtorët e klinikave, instituteve dhe shërbimeve të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), nga të cilët ka kërkuar shtim të kujdesit dhe komunikimit ndaj pacientëve. "Duhet të shtohet kujdesi dhe komunikimi më i mirë i stafit ndaj pacientëve. Kërkoj nga ana juaj të merrni përgjegjësi dhe zotësi. Kemi shprehur vullnet dhe gatishmëri. Kërkoj më shumë zotësi nga ana juaj. Jam aleat i juve, do të punoj me juve, kemi hapësirë, intelekt dhe pjekuri që të puno-

jmë bashkërisht", ka thënë Ismaili. Ai ka folur edhe për investimet që janë bërë dhe që janë në procedurë të realizimit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, përfshirë furnizimin me shtretër të ri, uniforma dhe çarçafë për klinikat e QKUK-së. Po ashtu, Ismaili ka përmendur renovimin e emergjencës së vjetër dhe furnizimin me pajisje për këtë klinikë. Sipas tij, është duke u punuar të krijohen barnatoret nëpër repartet dhe klinikat e QKUK-së, në mënyrë që furnizimi të jetë më i mirë dhe të ketë mbikëqyrje më të mirë.

Më tutje, ministri Ismaili ka thënë se është duke u punuar në çështjen e brendimit, ku përfshi-

hen informatat e përgjithshme me shenjat orientuese për klinikat dhe shërbimet që ofrohen. Gjatë këtij takimi Ismaili ka dëgjuar kërkesat e drejtorëve të klinikave për nevojën që kanë klinikat për investime, duke premtuar se do të angazhohet maksimalisht që investimet të jetësohen.

Ndërsa prof. dr. Naser Ramadani, kryesues i Bordit të ShSKUK-së, ka thënë se ky bord në mbledhjet e rregullta ka filluar t'i ftojë për raportim edhe drejtorët e klinikave, me qëllim që për së afërmi të njoftohet me gjendjen, me theks të veçantë të punohet për reduktim të listës së pritjes së pacientëve. "Ne kemi kuadro të mjaftueshëm që mos

të ketë listë të pritjes në asnjë klinikë. Andaj po angazhohemi t'i krijojmë kushtet e nevojshme në mënyrë që specialistët ta kryejnë punën e tyre dhe bashkërisht ta kryejmë obligimin etik-moral dhe ligjor", ka thënë Ramadani.

Në anën tjetër, Basri Sejdiu, drejtor i Përgjithshëm i ShSKUK-së, ka informuar drejtorët e klinikave se ambulancat specialiste të ortopedisë dhe fiziatrisë kanë filluar punën në objektin e ri me kushte dhe infrastrukturë moderne dhe shpejt pritet ta fillojnë punën edhe ambulancat e tjera. "Jemi duke punuar që ta rrisim numrin e sallave të operacioneve për kirurgji vaskulare, neurokirurgji dhe kirurgji plas-

tike. Projekti i renovimit të emergjencës së vjetër është duke u finalizuar, do të ketë reception, do të mbyllet portat dhe do të ketë recepsione dhe pritore për pacientët. Hapësira në klinikat interne dhe emergjencë do të jetë bllok i mbyllur, pra nuk do të ketë qasje të palëve", është shprehur Sejdiu. Ai ka thënë se janë në rrugë të drejtë për përmirësim të infrastrukturës dhe transformim të shërbimit farmaceutik në klinika. Drejtori Sejdiu ka folur edhe për disiplinën në punë, duke theksuar se ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme konform kompetencave që ka duke kërkuar nga drejtorët e klinikave që të respektohet orari i punës.

## BE-ja po përcjell nga afër zhvillimet rreth rastit Blakaj

PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Bashkimi Evropian (BE) është duke ndjekur nga afër rastin e prokurorit Elez Blakaj i cili dha dorëheqje, duke e arsyetuar atë me presionet ndaj tij. "Pavarësia dhe autonomia e gjyqësorit, duke përfshirë edhe Prokurorinë, është e rëndësishme veçantë në këtë rast dhe duhet të mbrohet", është thënë në

deklaratën e Zyrës së BE-së në Prishtinë.

BE-ja u ka bërë thirrje të gjithëve që të përmbahen nga çdo sulm ndaj institucioneve të rendit dhe ligjit, duke përfshirë edhe shpifjet ndaj prokurorëve ose gjyqtarëve të caktuar. "Deklaratat e disa politikanëve dhe prokurorëve në Kosovë minojnë principet kryesore të rendit dhe ligjit. Po ashtu,

dërgojnë sinjale dekurajuese të të gjithë zyrtarët e gjyqësorit që janë duke u marrë me raste të ndjeshme dhe të rëndësishme", thuhet në deklaratën e Zyrës së BE-së në Prishtinë.

BE-ja ka përsëritur se hetimet e mbetura pezull duhet të vazhdojnë me profesionalizëm, duke respektuar ligjin dhe pa asnjë ndikim.






Caktohet prokurori i ri për vazhdimin e hetimeve për listat e veteranëve të UÇK-së

# 19 mijë veteranëve pritet t'u ndalen pensionet

Pas dorëheqjes së prokurorit Elez Blakaj, kryeparlamentari Kadri Veseli ka bërë me dije se i ka shkruar letër Këshillit Prokurorial të Kosovës në lidhje me hetimin për listat e veteranëve të UÇK-së. Ai ka thënë se në procesin e verifikimit të statusit të veteranëve të UÇK-së janë bërë manipulime. Edhe Kryesia e OVL-UÇK-së i ka bërë thirrje Prokurorisë së shtetit që kësaj çështje t'i shkojë deri në fund. Ndërkaq kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka paralajmëruar se pas ngritjes së aktakuzës do të merret vendim për ngritjen e masës së përkohshme që veteranëve të rrejtshëm t'u ndërpriten pagesat



EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 GUSHT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i ka shkruar një letër Këshillit Prokurorial të Kosovës, nga i cili ka kërkuar që hetimin për listat e veteranëve të UÇK-së ta çojë deri në fund. Veseli nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije se nga ish-prokurori Elez Blakaj është ftuar të dëshmojë dhe i është përgjigjur pozitivisht kësaj ftese. "Sot i kam dërguar një letër Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ushtria Çlirimtare e Kosovës është produkt i drejtpërdrejtë i popullit të Kosovës. Vetëm duke qenë e tillë ajo arriti ta përmbushë misionin e vet historik: çlirimin përfundimtar të atdheut. Të jemi të qartë, liria që sot e gëzojmë nuk erdhi vetëm nga pushkët e djemve e vajzave të radhitur në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Erdhi edhe nga kontributi i pakursyer i një populli të tërë, nga secili qytetar, që në kohë, vende e me mundësi të ndryshme, u angazhuan për ta bërë realitet ëndrrën e madhe të lirisë. Ky angazhim gjithëpopullor, në asnjë mënyrë, nuk duhet ngatërruar me çështjen e listave të veteranëve", ka thënë Veseli. Ai ka shtuar se nga liderët politikë dhe institucionale të vendit ka qenë i pari që ka tërhequr vëmendjen se në procesin e verifikimit të statusit të veteranëve të UÇK-së janë duke u bërë gabime, lëshime dhe manipulime. "Për këtë, dëshmitë janë në dispozicion të secilit. Mjafton të bëhet një kërkim i thjeshtë në internet", është shprehur ai.

Kryeparlamentari Veseli ka theksuar se që nga ajo kohë ka marrë me qindra letra dhe ka takuar dhjetëra ish-luftëtarë, të cilët i kanë dëshmuar atij për manipulimet dhe për padrejtësitë që u janë bërë atyre në procesin e verifikimit. "Për këtë, i kam dhënë mbështetje të plotë procesit të hetimeve të këtyre manipulimeve, të cilat, sot, po konfirmohen edhe nga ish-komandantët e zonave operative të UÇK-së. Për qëndrimin që kam mbajtur rreth kësaj çështjeje, nga ish-prokurori Elez Blakaj jam ftuar të dëshmoj, ftesë së cilës i jam përgjigjur pozitivisht dhe me shumë përgjegjësi. Prokurori Blakaj e nisi mirë punën e tij, por ajo mbeti në gjysmë. Transparenca e situatës së krijuar rreth tij duhet të bëhet e plotë dhe secili ta marrë përgjegjësinë për veprimet dhe mosveprimet e tij, kushdo qoftë dhe pavarësisht funksionit që ushtron në shtetin e Kosovës. Hetimet e nisura nga prokurori Blakaj duhet dhe do të vazhdojnë. Duhet të shtohen", ka deklaruar Veseli.

Ai ka shtuar se transparenca dhe

përgjegjësia duhet dhe do të jenë të plota. "E them këtë si ish-luftëtar i UÇK-së, si lider politik e institucional dhe si taksapagues. Kjo nënkupton tri gjëra: Në listat e veteranëve nuk bën të ketë veteranë të rrejshëm, institucionet e shtetit nuk bën të bëjnë asnjë lëshim sa i përket sundimit të ligjit dhe taksat e qytetarëve të Kosovës nuk bën askush t'i shpërdorjë", ka thënë Veseli.

Lideri i PDK-së, duke folur rreth kësaj çështjeje, ka treguar se ka bërë një veprim të padrejtë me familjarët e tij. "Dikush, me të drejtë, mund të pyesë se si qëndron familja ime në çështjen e listave të veteranëve. Që nga viti 1991, kur kam dalë në ilegalitet, familja ime ka qenë pjesë aktive e angazhimit tim. Më vonë të gjithë ishin pjesë e luftës, por vetëm një prej tyre është

bërë veteran. Kam bërë një veprim të padrejtë me familjarët e mi, duke ua mohuar një të drejtë legjitime, vetëm që të mos ketë keqkuptime dhe për të dhënë një shembull personal. Faktet janë dhe mund të verifikohen lehtësisht prej kujtdo që dëshiron. UÇK-ja u ngre për t'i dhënë fund një padrejtësie të madhe historike. Sot nuk duhet të lejohet askënd të bëjë padrejtësi, as në emër të saj dhe as me emrin e saj", ka theksuar Veseli.

Ndërkaq kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka thënë të mërkurën se hetimi për keqpërdorimet me listat e veteranëve të UÇK-së tash i është dhënë një prokurori tjetër pas dorëheqjes së bujshme të prokurorit special Elez Blakaj. Në një konferencë për medie, Lumezi ka bërë me dije se një prokuror tjetër e ka marrë rastin, por iu ka shmangur përgjigjes se cili prokuror e ka marrë këtë rast. "Duke e parë këtë situatë, ne kemi vendosur që një prokuror nga Prokuroria Speciale ta vazhdojë plotësimin e asaj aktakuze sipas sugjerimeve të Prokurorisë Speciale dhe shumë shpejt do ta ngrehim atë aktakuzë. Është caktuar prokurori i cili do ta trashëgojë atë lëndë dhe është formuar ekipi i bashkëpunësorëve profesionalë", ka thënë Lumezi. Ai ka përsëritur se aktakuza e

përgatitur nga prokurori Elez Blakaj ka pasur mangësi për shkak të mungesës së emrave të 19 060 përfituesve në listat e veteranëve. "Është e vërtetë që prokurori Blakaj i ka deklaruar dhe emrat e personave që kanë përfituar në mënyrë të kundërligjshme, por ata emra nuk i ka në aktakuzë", ka thënë ai.

Lumezi ka thënë se pret që pas ngritjes së aktakuzës gjykata do të marrë vendim për ngritjen e masës së përkohshme në mënyrë që këtyre veteranëve të rrejshëm t'u ndërpriten pagesat. "Kërkesa e kryeprokurorit ka qenë që të përfshihen ata emra, në mënyrë që të propozojmë që të ndalen pasojat e dëmshme të shkaktuara nga veprimi i kundërligjshëm. Konkretisht që të ndalet shpërndarja e 3.6 milionë eurove në muaj për këta 19 mijë veteranë", ka thënë Lumezi. Ai ka thënë se pavarësisht prej thirrjeve për dorëheqje, sidomos nga opozita dhe shoqëria civile, nuk do ta bëjë një gjë të tillë, duke theksuar se dorëheqjen do ta ofronte vetëm në rast se atë e kërkon institucioni përkatës. "Do të jap dorëheqje nëse e kërkon Këshilli Prokurorial i Kosovës, nëse mendon se unë kam bërë shkelje. Nuk i bindem presionit politik nga subjektet politike, nga shoqëria civile apo dikush tjetër", ka thënë Lumezi.

## OVL-UÇK-ja përkrah hetimin e listave për veteranët e UÇK-së

Kryesia e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në mbledhjen e mbajtur të mërkurën ka diskutuar rreth çështjes së listave të veteranëve. OVL-UÇK-ja ka ftuar Prokurorinë e shtetit që t'i hetojë listat dhe ka kërkuar nga institucionet e drejtësisë që kësaj çështje t'i shkojnë deri në fund. "I kundërshtojmë ashpër tendencat e denigrimit të luftës së UÇK-së dhe figurave tona të luftës, posaçërisht kryekomandantit tonë Adem Jashari. Kërkojmë nga Prokuroria t'i hetojë njerëzit si Nexhmedin Spahiu për shpifjet dhe falsifikimet që i bënë. Ne si OVL UÇK do të ngrehim padi", është bërë me dije në komunikatën e OVL-UÇK-së.

## Protestuesit kërkojnë dorëheqjen e kryeprokurorit Lumezi



PRISHTINË, 22 GUSHT - Në qendër të kryeqytetit është mbajtur të mërkurën protesta në të cilën është kërkuar dorëheqja e kryeprokurorit të shtetit, Aleksandër Lumezi, pas pretendimeve se ka ndërhyrë në hetimet e zhvilluara nga prokurori Elez Blakaj në rastin e listave të veteranëve të UÇK-së. Krenare Loxha nga Këshilli i

Protestës, me moton "Shkarkim prokurorit - veting gjyqësorit", ka thënë para protestuesve se kjo protestë ka për qëllim ta mbrojë qytetarin. "Është protestë kundër atyre të cilët që 20 vjet po na cenojnë të drejtën për zhvillim ekonomik", ka thënë Loxha.

Gjatë marshimit, protestuesit po brohorasin: "Lumez, ik!", "Pishpirik

je vetë", "Ramush, ik!" Kërkesa e protestuesve ishte dorëheqja e kryeprokurorit Aleksandër Lumezi dhe fillimi i një procesi të vetingut në drejtësi. Kjo protestë është mbajtur pak ditë pasi prokurori special i dorëhequr, Elez Blakaj, akuzoi kryeprokurorin Lumezi për ndërhyrje në hetimet në rastin e listave të veteranëve të UÇK-së.



Ish-kryeministri Bajram Rexhepi përkujtohet në njëvjetorin e vdekjes

## Bajram Rexhepi do të mbahet mend për kulturën e lartë demokratike

Kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë marrë pjesë të mërkurën në akademinë përkujtimore të organizuar nga Komuna e Mitrovicës, në njëvjetorin e vdekjes së ish-kryeministrit Bajram Rexhepi, për të cilin u tha se do të mbahet mend për kulturën e lartë demokratike, shpirtin tolerant, frymën fisnike dhe modestinë njerëzore



EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

MITROVICË, 22 GUSHT - Të mërkurën është mbajtur akademi përkujtimore në qytetin e Mitrovicës me rastin e njëvjetorit të vdekjes së ish-kryeministrit të Kosovës, Bajram Rexhepi. Me nga një fjalë rasti të pranishmëve iu drejtuan kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj, kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ndërsa për jetën dhe veprën e ish-kryeministrit Bajram Rexhepi foli Nexhmedin Spahiu.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Kadri Veseli, ka thënë se trashëgimia e tij politike dhe humanitare është burim frymëzimi. "Kryeministri Bajram Rexhepi i dha shumë vendit të vet. Në njëvjetorin e ndarjes së tij nga jeta kujtuam me krenari veprën e tij në luftën për liri dhe në ndërtimin e shtetit. Trashëgimia e tij politike dhe humanitare është burim frymëzimi për ne", ka thënë Veseli.

Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se kujdesi për kujtimin, për veprën e njerëzve që gjatë jetës së tyre kanë bërë punë, shërbim për të tjerët, për shumicën, për popullin, po kthehet në një kult. Ai ka evokuar kujtime për

ish-kryeministrin Bajram Rexhepi, duke thënë se e ka njohur pak më vonë dhe jo gjatë kohës së UÇK-së, por ajo që ka kuptuar Haradinaj është se ai ka qenë me një sjellje të jashtëzakonshme, një komunikues i veçantë dhe një prej

atyre që u ka dhënë mundësi njerëzve. "E mbaj mend për një njeri të arsyeshëm, që u ka dhënë arsye mendimeve të tjerëve, pikëpamjeve; nuk ka qenë i ngurtë dhe nuk ka bllokuar pikëpamje e mendime, por ka qenë i hapur për t'i dëgjuar ato", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se Bajram Rexhepi ka qenë njeri shumë bujar.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se ish-kryeministri Rexhepi ka qenë njeri me qëllime humane, që ka dashur të ndodhin punë të mira dhe të ndodhin atje ku është më me rëndësi dhe nevojë, si dhe nuk ka qenë njeri që ka vrapuar pas meritokracisë së caktuar. "Përulëm me respekt para kujtimit dhe veprës së ish-kryeministrit Bajram Rexhepi", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Edhe presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka përkujtuar ish-kryeministrin Bajram Rexhepi me rastin e njëvjetorit të vdekjes së tij. Thaçi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Rexhepi do të mbahet mend si njeri tolerant

dhe fisnik. "Dje u bë një vit nga vdekja e ish-kryeministrit të Republikës së Kosovës, Bajram Rexhepi, që prapa vetes la një trashëgimi të pasur si humanist, doktor i luftës, lider politik, kryeministër dhe bartës i funksioneve të tjera të larta shtetërore. Ish-kryeministri Bajram Rexhepi do të mbahet mend për kulturën e lartë demokratike, shpirtin tolerant, frymën fisnike dhe modestinë njerëzore si vlera që i reflektoi dhe i shpërndau me të tjerët, qoftë para luftës, gjatë viteve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe në kohën e rindërtimit të Kosovës. Jemi krenarë që Kosova ka dhënë një profil politikani dhe burrështetasi si Bajram Rexhepi", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Pjesëmarrës në këtë akademi përkujtimore ishin edhe ministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, personalitete të ndryshme nga jeta politike dhe shoqërore dhe qytetarë të shumtë.

Bajram Rexhepi lindi në Mitrovicë më 3 qershor 1954, ndërsa vdiq më 21 gusht 2017 pas një sëmundjeje të rëndë.



## Qeveria jep 300 mijë euro për delegatët e vitit 1990

PRISHTINË, 22 GUSHT - Qeveria e Kosovës i ka ndarë 300 mijë euro për delegatët e Kuvendit të Kosovës të cilët më 2 korrik të atij viti shpallën Deklaratën Kushtetuese dhe më 7 shtator shpallën Kosovën Republikë. Propozimi i dhënë nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale,

Skender Reçica, në mbledhjen e sotme të Qeverisë, u mbështet nga të gjithë anëtarët e Qeverisë. "Sipas këtij propozimi, të drejtën do ta gëzojnë 111 delegatët të listuar në gazetën zyrtare. Shuma do të ndahet proporcionalisht për 111 delegatët", ka thënë min-

istri Reçica.

Ai ka bërë me dije se ndarja e kësaj shume bëhet "duke marrë për bazë kontributin, moshën dhe gjendjen e tyre ekonomike". Sipas këtij vendimi, secili nga 111 delegatët e atëhershëm të Kuvendit do të marrë nga 2 702 euro.





# Për bizneset, vetëm regjistrimi është i lehtë

Në tregun e Kosovës në gjashtë muajt e parë të këtij viti janë regjistruar 480 biznese të reja, prej tyre 170 biznese të huaja, thonë zyrtarë të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, agjenci kjo që funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë

PRISHTINË, 22 GUSHT - Fillimi i një biznesi të ri në Kosovë, ku ka të bëjë me regjistrimin e bizneseve, është proces i lehtë për t'u realizuar, thonë përfaqësues të komunitetit të biznesit, sipas të cilëve, vështirësitë për zhvillimin e veprimtarisë së tyre vazhdojnë më pas.

Edhe raporti i fundit i Bankës Botërore "Të Bërit Biznes 2018" konfirmon përparim në përmirësimin e mjedisit afarist në Kosovë, duke rritur renditjen në vendin e 40 në botë, nga gjithsejtë 190 shtete sa kanë qenë të përfshira në këtë raport. Përparim të konsiderueshëm, sipas raportit, Kosova ka shënuar në disa indikatorë si, fillimi i një biznesi, marrja e kredive, por edhe përfundimi i biznesit.

Lumnije Ajdini nga Aleanca Kosova e Re konsideron se në Kosovë është lehtë vetëm regjistrimi i biznesit, por jo edhe mbijetesja e bizneseve në faza të zhvillimit.

Në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", Ajdini shprehet se, pavarësisht prej reformave që kanë bërë autoritetet kompetente në të bërit biznes, ende ekzistojnë barrierat dhe pengesa të ndryshme që pengojnë zhvillimin e një biznesi. "Pas regjistrimit të bizneseve ato hasin në vështirësi të ndryshme sepse ende nuk e kemi legjislacionin e harmonizuar me udhëzimet administrative, siç është Ligji për investime strategjike, Ligji për pushime tatimore, ligje këto që janë favorizuese për bizneset e reja të



cilat duhet jo të mbijetojnë, por të zhvillohen", është shprehur Ajdini.

Sa iu përket pushimeve tatimore, Qeveria e Kosovës gati tre vjet më parë kishte marrë vendim të ketë pushime nga taksat për të gjitha investimet e reja, tre deri në shtatë vjet, por që një vendim i tillë ende nuk ka hyrë në fuqi.

Edhe drejtori ekzekutiv i Odës Tregtare të Afarizmit në Kosovë, Ismet Mulaj, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", thotë se ka përparime të jashtëzakon-

shme sa i përket regjistrimit të bizneseve, por ai përmend barrierat e tjera pas regjistrimit të biznesit. "Prej faktit të sigurimit të tokës, qasjes në energji elektrike, qasjes në infrastrukturë, këto janë një numër barrierash të mëdha që u shkaktohen bizneseve, konkretisht biznesit prodhues, duke përfshirë këtu edhe pengesat e tjera burokratike. Kosova ka një administratë shumë të madhe publike dhe biznesi detyrohet të orientohet në shumë adresa dhe këto shumë adresa e humbin

efektin tek biznesi. Por edhe gjykatat janë një problem shumë i madh, sepse kontestet e bizneseve nuk trajtohen me vite të tëra, deri në 10 vjet nuk përfundojnë", ka thënë Mulaj.

Edhe Lumnije Ajdini përmend kontestet gjyqësore si probleme që ndikojnë te bizneset, por edhe investitorët e huaj. "Ende kemi sistemin bankar të shtrenjtë, kontestet gjyqësore, duke ditur se në sistemin gjyqësor në Kosovë ka lëndë shumë të ngarkuara. Kurse sa iu përket bizneseve, janë mbi një mijë lëndë që kanë konteste të ndryshme gjyqësore në mes të palëve. Si pengesa të tjera gjatë bërjes së biznesit është konkurrenca jolegale dhe informaliteti që është një rangim, mandej probleme me energjinë e elektrike që po ballafaqohen bizneset tona, por edhe investitorët e huaj", ka deklaruar Ajdini.

Në bazë të një raporti të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, mesatarja e ditëve për regjistrimin e të gjitha shoqërive tregtare për vitin 2017 ka qenë 1.96 ditë.

## Fitimet nga bujqësia janë ulur në vitet e fundit



PRISHTINË, 22 GUSHT - Çmimet e ulëta, dëmet nga fatkeqësitë natyrore dhe mungesa e përkrahjes institucionale po bëjnë që shumë fermerë të mendojnë të heqin dorë nga bujqësia. Disa prej tyre nga Krusha e Madhe e Rahovecit thonë se si pasojë e këtyre faktorëve ata çdo vit po zvogëlojnë sipërfaqet e mbjella. Sipas kreut të këtij fshati, shumë të rinj po largohen nga fshati duke mos parë perspektivë në bujqësi. Bujqësia nuk është në ditët më të mira dhe pak po përkrahet, andaj

edhe shumë të rinjtë po heqin dorë nga kjo veprimtari. Ky është një pjesë e rrëfimit të Selami Hotit, kryetarit të Krushës së Madhe, banorët e të cilit fshat tradicionalisht merren me bujqësi. "Rinia është duke u larguar nga kjo fushë. Në bazë të një statistike që e kemi si fshat, diku 400 të rinj në dy vjetët e fundit janë larguar nga fshati. Do të thotë se 400 familje ndoshta vitin e ardhshëm nuk do të merren me bujqësi", ka deklaruar Selami Hoti. Sipas Hotit, kjo situatë alar-

mante duhet të trajtohet me seriozitet dhe bujqve t'u kthehet shpresa për punë.

Krushjani Muharrem Hoti, i cili në pranverë mbolli nëntë hektarë me kultura të ndryshme perimore, tregon për "Radio Kosovën" se fitimet nga punimi i tokës kanë rënë dukshëm përderisa, sipas tij, shteti nuk po u del në ndihmë bujqve të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore. "Dëmet ka shumë. Për neve janë të mëdha. Ndoshta për ata në Prishtinë, që janë në pushtet, dëmet s'janë të

mëdha, ama neve na ka qitur në gjunjë. Unë nëntë hektarë bahçe i kam, edhe përsëri fukara jam, se nuk fitojmë kurrëgjë, veç bëjmë mundë", ka deklaruar Hoti.

Edhe bujku Muharrem Gashi ankohet se fitimet nga bujqësia janë ulur vitet e fundit. Ai thotë se këtë vit e ka problem t'i nxjerrë investimet e bëra në pranverë dhe shton se gradualisht po heq dorë nga puna me të cilën merret prej vitësh. "Unë vjet i kam pasur të mbjellë tre hektarë e gjysmë me specë. Sivjet i kam dy hektarë. Vitin

tjetër një hektar do ta mbjell. Nuk ka fitime. Derisa nuk ka fitime, pse të investoj kot?! I kisha lutur të gjitha institucionet të marrin pak masa, sepse si po shkon puna në vitet e fundit, nuk kemi pse të merremi me këtë bujqësi", ka deklaruar ai.

Ndërsa Ministria e Bujqësisë, për t'i ndihmuar bujqit, këtë vit ka ndarë 25 milionë euro subvencione, që do të ndahen për pagesa direkte dhe 26 milionë të tjerë bujqve do t'u ndahen si grante investive. (Rtklive)



## 'EC Ma Ndryshe': Drejtoria e Urbanizmit në Prizren mbetet jotransparente

Prizren, 22 gusht (ER) - "EC Ma Ndryshe" kohët e fundit është duke e vërejtur një mungesë të theksuar të transparencës dhe llogaridhënies të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor e Komunës së Prizrenit. "EC"-i përmes një komunikate për medie është duke hasur vazhdimisht në vonesa dhe në përgjigje jo të plota nga kjo drejtori. Në rastin e parë "EC" ka kërkuar informata nga DUPH-ja lidhur me rishikimin e kushteve të lejes për një ndërtesë në Qendrën Historike të Prizrenit. "EC" më 3 gusht 2018 ka kërkuar informata lidhur me këtë rishikim, por ende nuk ka pranuar asnjë përgjigje. Në rastin e dytë "EC"-i ka kërkuar informata zyrtare nga DUPH-ja lidhur me planin rregullues në zonën afër "Euro Center" si dhe sqarime për kushtet dhe lejen ndërtimore për një ndërtesë shumëbanesore. Kërkesa e njëjtë është dërguar edhe më 11 qershor 2018, por përsëri DUPH-ja nuk ka ofruar përgjigje brenda afateve ligjore, është thënë në komunikatën e "EC Ma Ndryshe", duke shtuar se, pavarësisht prej faktit se qev-



erisja e re komunale ka premtuar transparencë radikale, këto raste tregojnë se nuk ka përpjekje të mjaftueshme në këtë drejtim. "EC"-i rikujton se në 'Indeksin e Reformës së Transparencës Komunale', Komuna e Prizrenit vite me radhë vlerësohet me notë negative, veçanërisht indikatorët që kanë të bëjnë me planifikimin urban dhe monitorimin e projekteve urbanistike. Prandaj 'EC Ma Ndryshe' rekomandon Komunën e Prizrenit, respektivisht Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, që t'i zbatojë në përpikëri dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, duke zbatuar praktika që e rrisin nivelin e transparencës dhe duke eliminuar vonesat në ofrimin e përgjigjeve lidhur me kërkesat për qasje në dokumente publike dhe informata zyrtare", është theksuar në komunikatën "Ec Ma Ndryshe".



## Qeveria ndan 1.1 milion euro për vërshimet në Suharekë

PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Qeveria e Kosovës ka ndarë 1.1 milion euro për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në Komunën e Suharekës. Ky vendim është ndarë të mërkurën në mbledhjen e rregullt të Qeverisë. Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka treguar se propozimi i ministrit së tij vjen pas

shqyrtimit të kërkesës së Komunës së Suharekës e cila ka kërkuar nga Qeveria që t'i dalë në ndihmë. "Komuna e Suharekës ka bërë kërkesë për mbështetje financiare për sanimin e dëmeve të vërshimeve, Ministria e Financave pas shqyrtimit të kërkesës dhe në konsultim me Qeverinë ka propozuar të ndahen si mjete emergjente shuma prej

1.1 milion eurosh dhe pjesa tjetër e dëmeve të trajtohet me procedurë të rregullt", ka thënë Hamza.

Propozimi i tij është mbështetur unanimitisht nga kabineti qeveritar. 100 mijë euro pritet të përdoren për sanimin e dëmeve në infrastrukturë derisa pjesa tjetër për ekonominë e shkatërruara familjare.

## Punimet në shkallët e lagjes 'Arbëria', në fazën finale

PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Projekti i rregullimit të shkallëve në lagjen "Arbëria" po shkon drejt përfundimit, me një mbikëqyrje profesionale nga ana e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave.

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se janë duke u kujdesur që kualiteti i punimeve të jetë sa më i lartë pavarësisht prej reshjeve të shumta që kanë shkaktuar



telashe. "Tani janë marrë mostrat e shtresës së betonit që është vendosur për nivelizim të shkallëve, si dhe të atij në objek-

tin përcjellës nga ku shihet panorama e Prishtinës. Këto mostra do të analizohen në laboratorët e licencuara të betonit dhe vetëm pas marrjes së rezultateve pozitive do të vazhdohet me vendosjen e gurëve natyrorë, si fazë përfundimtare e këtij projekti. Aktualisht janë duke u testuar edhe punët e kryera në kanalizimin atmosferik, si dhe në kabllor nëntokësor", ka thënë Ahmeti.

## Ministri Bytyqi: Kemi siguruar 400 bursa për nxënësit e marginalizuar

GJAKOVË, 22 GUSHT (ER) - Qendrat mësimore të komunitetit në Brekoc të Gjakovës janë vizituar të mërkurën nga zyrtarët qeveritarë, përfshirë ministrin e Arsimit, Shyqiri Bytyqi, drejtorin e GIZ-it, David Oberhuber dhe kryetarin e kësaj komune, Ardian Gjini. Ky i fundit ka thënë se këto qendra kanë rëndësi jo vetëm për komunitetet, por edhe për Gjakovën në tërësi, ku në bazë të mundësive do të mundohen t'i rrisin kapacitetet e reja. "Ngjyra e lëkurës nuk paraqet dallim as te mjekët e as tek inxhinierët, e këto do të bëjnë që pas një kohe mos të



kemi të tilla diskutime", ka thënë Gjini.

Ndërsa drejtori i GIZ-it, David Oberhuber, është shprehur i gatshëm për bashkëpunim me qëllim të edukimit gjithëpërfshirës. "Arrija e barazisë arrihet duke i mbështetur komunitetet", ka

thënë ai. Ndërsa ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka bërë me dije se kanë siguruar 400 bursa për nxënësit e marginalizuar për ta vazhduar shkollimin e mesëm dhe 600 të tjera që janë ndihmuar nga partnerët e huaj. Këto qendra kanë kapacitet për 215 nxënës.

## Filmi 'Ajo' i More Raçës fiton të drejtën për aplikim në Oscar

PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Filmi "Ajo" është një nga nëntë filmat finalist në Festivalin Manhattan Short Film Festival që do të mbahet nga 27 shtator deri më 7 tetor 2018. Filmi do të shfaqet në 350 qytete të botës, në gjashtë kontinente. Në këtë festival të rëndësishëm çdo vit konkurrojnë 2 000 filma prej të cilëve nëntë përzgjidhen finalistë të festivalit. Filmat finalistë shfaqen për një javë në kinema në "Los Angeles" dhe fitojnë të drejtën e konkurimit në Oscar. Filmi "Ajo" me skenar dhe regji

nga More Raça dhe producent Sunaj Raça flet për dhunën në familje, guximin e një vajze të vogël për ta shpëtuar vetën dhe nënën e saj. Në filmin "Ajo" luajnë: Aurita Agushi, Sunaj Raça, Diella Valla, Florist Bajgora etj. Filmi është prodhim i shtëpisë filmike "Arena", i subvencionuar nga Qendra Kinematografike e Kosovës. Në edicionet e mëparshme të Manhattan Short Film Festival finalistë ishin dy filma të cilët u nominuan për çmimin Oscar, filmi "Shok" dhe "Bear Story".





## PO E THE TË VËRTETËN, ARMIQTË I KE NË DERË



Shkruan: Jakup KRASNIQI

Populli ynë, në fjalorin dhe mendësinë e vet filozofike, ka shpjegim adekuat për çdo situatë, edhe për zhvillimet e këtyre ditëve. Dhe është më shumë se i saktë në këtë reflektim imediat. I urti popull thotë: "Më lehtë është ta luash qarkun sesa të folësh hakun!" Kjo u pa edhe këtyre ditëve, e sidomos pas bërjes konkrete të arsyes pse ishte larguar prokurori Blakaj. Reagimet e shumta që erdhën pas letrës së prokurorit të "vetëlarguar", e sidomos të atyre

që do të duhej ta ndihmonin në kryerjen e detyrës së tij fisnike, po më bindin se vërtet në ambientin tonë e vërteta vret shumë dhe do të duhej të ishte e kundërta, do të duhej t'i gëzo-heshim të vërtetës së zbardhur! Prokurori që e tha një të vërtetë edhe mund ta kryqëzojmë, por ai nuk e pati gatishmërinë e Krishtit e as përkushtimin e Adem Jasharit. Në fakt ai është një hero në mbrojtje të shtetit, të shtetit që ka shumë mundësi të falimentojë financiarisht. Bile së paku është guxim, sa ishte guximi i atyre që ishin rreshtuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për ta bërë shtetin. UÇK-ja ka luftuar për shtetin e pavarur, sovran e demokratik edhe prokurori po e mbron funksionimin e shtetit të pavarur, sovran dhe demokratik. Kuptohet, me mjete të tjera, me

ato mjete që e mbrojnë shtetin sot. Mua nuk me frikëson prokurori që e tha një të vërtetë që e dimë të gjithë, e më të saktën e tha dje nga burgu Syleman Selimi, por më frikësojnë deklaratimet e atyre që kanë përgjegjësi dhe marrin para të shumta për ta mbrojtur shtetin nga mashtruesit e abuzuesit e tij. Dhe ata e bëjnë të kundërtën! Kjo është frika! Frika nga e vërteta, të cilën kërkojnë ta mbyllin në epruvetën e krimit laboratorik! Kështu nuk mbrohet Ushtria Çlirimtare e Kosovës, për të cilën punuan se paku tre breza atdhetarësh për nëntë dekada, por as bëhet e mbrohet shteti. Prokurori edhe mund të ketë qenë pjesë e atyre që ishin në Bllacë, por ai nuk ishte faji i tyre! Fajtorët që nuk e ndihmuan luftën, çlirimtarë i kanë futur në

gjirin e tyre për interesa mesquine! Fajtorë janë ata që dezertorët i bënë veteranë e deri në heronj, si dhe ata që fare nuk ishin ushtarë dhe sot nuk ju dhimbset paraja e shtetit! Sot jemi gati 20 vjet pas lufte. Ata që menaxhojnë buxhetin e krijuar nga tatimpaguesit, e paguhen nga ai buxhet dhe marrin paga goxha të mira, duhet t'i respektojnë edhe shumë bile që të gjithë qytetarët e shtetit, ishin apo nuk ishin në luftë. Liria ka ardhur për të gjithë! Shpërblim sipas meritës po, por jo të privilegjohej të pameritueshmit e mashtruesit! Kështu shteti nuk udhëhiqet dhe as nuk mbrohet! E di që për këtë që po e them s'do t'ju pëlqej shumëkujt, por unë nuk po shkruaj që t'ju pëlqej shumicës mashtruese. Po e them të vërtetën që edhe mund t'i vret

disa! Madje jo pak! Edhe ata që pa dëshirën e tyre ishin pjesë e vetëm e një Bllace a Stankoveci duhet respektuar! Edhe ata ishin pjesë e luftës që i ishte imponuar popullit tonë. Në këtë vend duhet thënë e vërteta nëse e duam zhvillimin e ndërtimin e shtetit të se drejtës! Nëse duam qytetarë të ndershëm, me dinjitet e integritet! Dhe shteti ka nevojë dhe ka nevojë shumë për njerëz të tillë. Sepse prapë duhet rikujtuar ajo që solla që në fillim: "Më lehtë është ta luash qarkun sesa të folësh hakun!" Dhe me këtë nënkuptohet se po e the të vërtetën, armiqtë i ke në derë! E vërteta duhet thënë, se për te populli ynë ka flijuar shumë! Madje, për këtë të vërtetë kanë flijuar edhe disa që po duan ta heshtin! Natyrisht që këta me dhimbjen edhe goxha shumë!

## NGA TOPLICA NË PRIZREN, IVICA DAÇIQI, PINJOLL I NJË FAMILJEJE ME TRADITË POLICORE



Shkruan: Ramadan AVDIU

Jemi dëshmitarë të shumë komenteve dhe diskutimeve të ministrit të Punëve të Jashtme të Serbisë, Ivica Daçiçi, lidhur me numrin e serbëve që kanë jetuar në Kosovë dhe që janë shpërngulur. Zakonisht, nga ana e serbëve janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen manipulime të mëdha me shifrat. Në Kosovë numri më i madh i serbëve që është regjistruar ndonjëherë është ai i regjistrimit të popullsisë në vitin 1991, kohë kur në këtë regjistrim të popullsisë nuk kanë marrë pjesë shqiptarët (të gjithë regjistruesit kanë qenë serbë). Në atë kohë janë regjistruar 194 190 serbë dhe 20 365 malazezë. Nëse aktualisht rreth 130 mijë serbë jetojnë në Kosovë, atëherë nga viti 1981 e deri sot kanë mundur të shpërngulen më së shumti 80 mijë serbë, duke marrë parasysh edhe proporcionin e ritmit të shtimit natyror të popullsisë... Por sikurse Ivica Daçiçi, edhe të gjithë zyrtarët serbë flasin me pompozitet, se vetëm pas luftës çlirimtare të UÇK-së nga Kosova janë zhvendosur në Serbi 200 mijë serbë. Pavarësisht nga ajo se është e dokumentuar përmes regjistrimeve të popullsisë se asnjëherë në Kosovë nuk kanë jetuar 200 mijë serbë, serbët vazhdojnë ta aplikojnë instruksionin e Dobrica Qosiqit, se në vazhdimësi duhet gënjer, ngaqë

gënjeshtroja e stërpërsëritur zë vend dhe dikur në mendjet e njerëzve do të perceptohet si e vërtetë. Mbase në shifrën prej 200 mijë vetash, që e përmendin rëndom Daçiçi dhe zyrtarët e tjerë serbë, i llogarisin edhe policët, ushtarët dhe pjesëtarët e formacioneve të tjera të armatosura, të cilët kanë qenë të angazhuar në luftë kundër UÇK-së dhe kanë ushtruar gjenocid kundër shqiptarëve në Kosovë. Gjatë luftës në Kosovë 1998-1999, ka pasur mbi 150 mijë forca të armatosura serbe. Një numër i konsiderueshëm e tyre kanë qenë serbë lokalë të mobilizuar, të cilët nga frika se do të ndëshkohen për krimet e bëra kundër popullsisë civile shqiptare, kanë ikur nga Kosova bashkë me forcat pushtuese serbe. Një pjesë e tyre janë tërhequr nga Kosova pas kapitullimit të Serbisë dhe në bazë të marrëveshjes së nënshkruar në Kumanovë më 09.06.1999. Serbët nga Kosova, të cilët nuk kanë marrë pjesë në krime dhe gjenocid kundër shqiptarëve, nuk janë larguar dhe vazhdojnë të qëndrojnë e jetojnë në Kosovë, ku gëzojnë të drejta më shumë se çdo pakicë kombëtare në ndonjë shtet të botës... Ivica Daçiçi shpesh përmend faktin, se edhe ai vetë është një prej serbëve të larguar nga Kosova. Por, si ka shkuar Daçiçi në Kosovë?! Të gjithë duhet ta dinë, ose duhet të sqarohen se si ka shkuar dhe si është shpërngulur ai dhe familja e tij nga Kosova. Në një emision të mëngjesit, në televizionin "Hyppy", ai zbuloi një pjesë të origjinës së tij. Ai përmendi faktin se kishte lindur në Prizren dhe se babai i tij ka qenë polic i dërguar në Kosovë në vitet '60-ta të shekullit të kaluar. Ai

ishite dërguar atje nga regjioni i Toplicës, duke theksuar se "mbase edhe atëherë shqiptarët kanë pasur pretendime secesioniste të cilat nuk kanë pasur një arsye", përse babai i Ivicës, polici Desimir Daçiçi, është dërguar bashkë me shumë policë të tjerë për të shtypur aspiratat e shqiptarëve dhe për t'i nënshtruar ata. Pra, babai i Ivica Daçiçit ka qenë i dërguar si polic nga Serbia, bashkë me shumë policë të tjerë, për të shtypur shqiptarët. Një numër i konsiderueshëm i policëve dhe i pjesëtarëve të tjerë të aparatit okupues represiv serb, që kanë qenë të dërguar në Kosovë nga Serbia, nëse kanë qëndruar qoftë edhe një muaj, janë regjistruar si banorë të Kosovës dhe, si të tillë, regjimi pushtues serbë ka tentuar t'i mbajë gjithmonë, pavarësisht se janë kthyer në shtëpitë e tyre. Kështu, duke mos qenë asnjëherë banorë të Kosovës, ata janë shndërruar në banorë të saj, me qëllim të ndërrimit të strukturës së popullsisë gjatë paraqitjes së statistikave. Kjo edhe sot vazhdon t'u shërbejë si margjinë për manipulim. Ivica Daçiçi duhet, paraprakisht, të shpjegojë se si dhe prej nga ka shkuar familja e tij në Toplicë. Sepse deri në vitin 1878, e tërë Toplica ka qenë e banuar ekskluzivisht nga shqiptarët. Daçiçi duhet të shpjegojë se në pronat e cilës familje shqiptare është vendosur familja e tij. Dihet tashmë se shqiptarët nga rajonet e Toplicës, Jabllanicës e Kosanicës janë shfarosur mizorisht nga soldateska serbe. Pra ndaj tyre në këto regjione, atëherë të pushtuara nga Perandoria Osmane, serbët kanë ushtruar gjenocid të paparë, ku për më pak se dy vjet,

më 1876-1878, janë vrarë e dëbuar rreth 500000 (pesëqindmijë shqiptarë) nga forcat e armatosura serbe në qytetet e sotme të Serbisë, si Nishi, Vranja, Prokupla, Leskovci dhe në 740 vendbanime të tjera me një sipërfaqe prej më shumë se 5 000 kilometra katrorë. Këto territore janë kolonizuar dhe populluar me serbë kurse e gjithë pasuria e shqiptarëve është shkatërruar ose është përvetësuar nga serbët, pra edhe nga familja Daçiçi, siç e pohon vetë ai... Kur të qartësohet itinerari i familjes së Daçiçit, do të qartësohet edhe fakti se ai është pinjoll i një familjeje, që ka marrë pjesë historikisht nga gjysma e dytë e shekullit XIX e deri në fund të shekullit XX, në keqtrajtimin dhe gjenocidin sistematik të ushtruar nga serbët kundër shqiptarëve. Prandaj ai e ka aq të manifestueshme urrejtjen dhe cinizmin kur flet për shqiptarët. Me gjuhën që flet Daçiçi zakonisht kanë folur dhe flasin ata kriminelë që kanë vrarë shqiptarë dhe duke u përpjekur të justifikojnë veprimet e tyre, kanë kriminalizuar edhe gjuhën, nga e cila sa herë që flasin për shqiptarët, nuk arrijnë të lirohen dot. Gjuha e kriminalizuar është edhe si rrjedhojë e mosndëshkimit, sepse serbët në disa faza kanë ushtruar gjenocid kundër shqiptarëve dhe nuk janë ndëshkuar. Prandaj kanë vazhduar dhe e kanë përsëritur gjenocidin me metoda të njëjta kundër shqiptarëve deri në fund të shekullit XX. Serbët nuk janë ndëshkuar për gjenocidin e bërë në vitet 1876-1878, përkundrazi janë shpërblyer, duke u njohur atyre tokat e pushtuara shqiptare. Nuk janë ndëshkuar as për gjenocidin kundër shqiptarëve në Luftërat

Ballkanike, 1912-1914, për gjenocidin kundër shqiptarëve në kohën e Mbretërisë së Jugosllavisë, për gjenocidin kundër shqiptarëve gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Serbët janë ndëshkuar nga Bashkësia Ndërkombëtare më 1999, vetëm për gjenocidin e ushtruar kundër popullsisë shqiptare në luftën e fundit në Kosovë, por nuk janë dënuar. Këtë ndëshkim ata mëtojnë ta paraqesin si agresion ndaj tyre... Kurse kanë orvatje të vazhdueshme që të justifikojnë veprimet gjenocidare të forcave të armatosura serbe e madje tash së fundi ka tendenca që të justifikojnë edhe bëmat e Millosheviçit, duke thënë se ai ka menduar për të mirën e serbëve, siç theksoi më 16.08.2018 kryetari i Serbisë, Aleksandar Vuçiçi. Krimet e gjenocidit serb të ushtruara kundër shqiptarëve në cilëndo kohë të përmendur më lart, tejkalojnë krimet e fashizmit dhe nazizmit gjatë Luftës së Dytë Botërore, madje tejkalojnë gjenocidin e nacizmit kundër popullit hebre... Fashizmi e nacizmi është ndëshkuar dhe populli i civilizuar gjerman e ka pranuar përgjegjësinë e tij. Gjermanët asnjëherë nuk janë përpjekur ta lavdërojnë ose rehabilitojnë Hitlerin, kurse serbët synojnë që kriminelin, i cili inspiroi gjenocidin e fundit në Evropë, ta shndërrojnë në hero dhe në vazhdimësi kanë qasje negacioniste ndaj gjenocidit të ushtruar kundër shqiptarëve. Kjo e vështirëson pajtimin. Një prej kushteve për përmirësimin e raporteve shqiptaro-serbe duhet të jetë që ata të pranojnë përgjegjësitë e tyre dhe të pranojnë se kanë ushtruar gjenocid kundër shqiptarëve dhe atë jo vetëm gjatë luftës së fundit...



# Çfarë thonë dokumentet serbe

**Në saktësim të shkrimit të z. Enver Robellit "Njëherë ia falsifikuan ditëlindjen, pastaj ia baltosën emrin"**



**Bedri ISLAMI**

Për ata që nuk e kanë lexuar: Robelli shkruan se ditëlindja e Adem Jasharit nuk është 28 nëntori, por 10 tetor 1955. Këtë e ka "zbuluar" Nexhmedin Spahiu. Pas luftës e quajtnë "komandant legjendar". Kur është quajtur ashtu? Kur luftoi e lanë vetëm. Përse ai sjell kuptimin e dytë, në të vërtetë figurativ, të fjalës legjendë dhe cili është kuptimi i fjalës legjendar dhe kuptimi primar i fjalës legjendë. Filluan të ia festojnë ditëlindjen më 28 nëntor, pas vrasjes, në Ditën e Flamurit... Ia baltosën emrin se aeroportin e Prishtinës e quajtnë "Adem Jashari". Edhe në Shqipëri, sipas këtij përcaktimi, duke i vënë emrin e saj aeroportit të Rinasit, ia paskemi baltosur emrin Nënë Terezës. Adem Jashari, shkruan ai, ishte një fshatar kryengritës. Hapi i parë, për ta zënë vendin e duhur në themelet e Kosovës, shkruan Robelli, është që tani e tutje Kosova t'ia festojë ditëlindjen më 10 tetor.

## Si është e vërteta?

Nuk e kam menduar kurrë se do të hapej një temë e tillë por, mirë që u hap, pavarësisht se me qëllimin e gjithmonshëm të një grupimi politik apo medial, për të degraduar një figurë mitike shqiptare, i cili nuk ishte, si thotë autori, një fshatar kryengritës, që u vra për ta mbrojtur pragun e shtëpisë së vet më 26 anëtarët e familjes. Prej 58 të vrasësve në marsin e vitit 1998, 32 prej tyre ishin luftëtarë, bashkëvendës dhe bashkëveprimtarë, të cilët u përpoqën t'i vijnë në ndihmë, si kishte ndodhur më 30 dhjetor 1991, kur Jasharët u rrethuan për herë të parë dhe, si kishte ndodhur më 22 janar 1998, kur u rrethuan për herë të dytë.

## A është lënë vetëm Adem Jashari?

Në rrethimin e 5 marsit, në orët e para të pasmesnatës, Adem Jashari, i sapokthyer në shtëpi,

me dajën e vet, Osman Gecin, nga një takim me bashkëluftëtarë në Açarë, u ndodh i rrethuar nga më shumë se 4 000 ushtarë specialë serbë, njësi të posaçme, mbi 200 makina të blinduara e tanke, dhe 15 gryka zjarri, të cilat, që nga vendi sipër kullave të tij, që quhej Fabrika e Municionit, qëllonin pa ndërprerje. Ishte nën rrethim jo vetëm lagjja e Jasharëve, por edhe e Lushtakëve dhe e Kodralive. Njëkohësisht janë rrethuar dhe kanë filluar luftimet edhe në Vojnik, ku ishte drejtues Abedin Rexha, në Açarë, Siçevë dhe Kopiliq. Llausha kishte nisur të bombardohej nga qendrat e forcave serbe në Polac. Nga drejtimi i Klinës drejt Vojnikut shkuan dhjetëra automjete të blinduara, pasi në Vojnik disa javë më parë ishte zhvilluar një betejë e ashpër kundër forcave serbe. Në Tushilë kishte, po ashtu, luftime. E, megjithatë, disa forca nga zona jashtë luftimit, si ato të drejtuara nga Ilaz Kodra, Musë Jashari, Jetullah Geci që ishte i plagosur, forcat e drejtuara nga Mujë Krasniqi, forcat e drejtuara nga Rasim Kiçina, Jahir Demaku me vëllezërit dhe shokët e tij të Drenasit etj. shkuan në ndihmë, por nuk mund ta çanin dot rrethimin ku ishin përqendruar forcat speciale serbe dhe grupi i Arkanit.

Pra, duke u përqendruar te shtëpia e Jasharëve, në fakt ishte rrethuar e gjithë ajo pjesë e Drenicës, e cila prej disa muajve kishte qenë si zonë e lirë. Ata që e lanë vetëm ishin krijuesit e lëvizjes "paqësore", si Bukoshi, i cili, sipas pohimit të Rifat Jasharit, vëllait të Ademit e Hamzës, edhe kur i kërkuan ndihmë, i përcollti me përbuzje. Vetëm pasi ata ranë, u kujtuan të organizonin aksionin "Gjithçka për Drenicën", ku grumbulluan dhjetëra milionë marka gjermane, të cilat, si do të thoshte më pas numri dy i qeverisë Bukoshi, Xhafer Shatri. Ndërkohë që në kufi vriteshin si qengjat njomakët që kishin ardhur për armë, paratë e fondit të Republikës së Kosovës ruheshin për "ditë të zeza". Ruheshin për Kosovën e pasluftës për të mbijetuar politikisht kryekopukët institucionalistë duke blerë me paratë e fondit vota e parti të ndryshme. Duke zhvilluar hapur e me para të popullit veprimtari kundër tij.

Shatri duhet ta ketë ditur mirë këtë punë, sepse ka qenë luga brenda vekshit.

Në fakt, si e kam shkruar në librin "Përjetësia e dyfishtë", mjetet e përcaktuara për të shkuar në Drenicë dhe për të cilat ishte bërë një marrëveshje mes Ramiz Lladrovci, në atë kohë përfaqësues i emëruar me shkrim nga Adem Jashari për Drenicën, Lulzim Jasharit dhe, nga ana tjetër, Azem Sylës, që ishte asaj kohe pjesëtar i Sektorit të veçantë, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, nuk u realizua asnjëherë, edhe për shkak të rrjedhës së shpejtë të ngjarjeve.

## A ishte Adem Jashari vetëm një fshatar kryengritës?

E kemi dëgjuar edhe nga të tjerë se Adem Jashari ishte një fshatar kryengritës që mbrojti pragun e shtëpisë së tij. Kjo e tashmja është thjesht një përsëritje.

Adem Jashari nuk "ishte një fshatar kryengritës", si përcakton Robelli, por drejtuesi i një strukture që po ngrihej, me vështirësi të mëdha, por me përkushtim. Të gjithë grupimet e deri asaj kohe në Kosovë dhe në Maqedoni, ku ishte zona e dytë operative, pavarësisht se disa me emrin e tij të luftës, "Rafalla", e njihnin si drejtuesin e tyre fuqplotë. Ai nuk veproi vetëm në Drenicë. Aktiviteti i tij u shtri në të gjithë Kosovën. Ai i besonte institucionit të luftës dhe jo veprimtari kaçak. Një shembull: më 11 shtator 1997, nën drejtimin e Adem Jasharit dhe me vendim të Shtabit Qendror të UÇK-së, (atëherë quhej Shtabi Qendror) në të njëjtën orë, të sinkronizuara, u organizuan 12 aksione kundër forcave policore serbe. Konkretisht: Kijevë, Glogovc, Runik, Irzniq, Ponošec, Suharekë, Ratkovc, Kličinë, Ozdrim, Çallapek, Llužhan dhe Kërpimëh.

Rreth tij vepronin grupet e veçanta të Dukagjinit, të Llapit, të Shalës dhe të Drenicës. Në paraqitjen e parë publike të UÇK-së kishte përfaqësues nga tri zona operative.

Letra e fundit e Adem Jasharit, drejtuar Lëvizjes Popullore të Kosovës, në dhjetor 1997, dhe që unë e kam publikuar më herët, është një dëshmi e jashtëzakonshme për luftën në Kosovë dhe për hallet e saj të pambarimtë.

Roli drejtues i Adem Jasharit nuk mund të përcaktohej nga grupime jashtë Kosovës; ai ishte bërë vetvetiu njeriu rreth të cilit mbledheshin gjithë të tjerët dhe që, si më thoshte një luftëtar i fillësës, "kishim padurim me e pa dhe gëzim me



i dhanë dorën". Këtë nuk ia hiqte, si nuk ia hoqi, asnjë përfaqësi politike.

## Kuptimi i fjalës legjendë dhe legjendar

Së pari: Në shkrimin e cituar, Robelli, duke kërkuar ta shpërdorjë termin "komandant legjendar" që i është atribuar Adem Jasharit, sjell përkufizimin e fjalës "legjendë", rastësisht apo me dashje, kuptimin e dytë dhe figurativ të saj. Në fjalorin e gjuhës shqipe ka dy përkufizime për fjalën legjendë. Kuptimin e saj direkt dhe atë figurativ. Po i sjell të dyja: 1. Gojëdhënë. Legjendë popullore. Legjenda e Mujit dhe e Halilit. Legjendat për Gjergj

Kastriotin. Mbeti legjendë. Hyri në Legjendë.

2. fig. Trillim që përhapet me qëllime të caktuara për dikë a për diçka; diçka që nuk i ngjan fare së vërtetës.

Përse Robelli ka zgjedhur pikërisht këtë përkufizim të dytë, aq më tepër kur saktësohet se është kuptim figurativ, e di vetë ai.

Megjithatë, Adem Jashari është cilësuar si "Komandanti i përgjithshëm legjendar".

T'i kthehemi fjalorit që citon Robelli, një rresht më sipër.

Në fjalor kuptimi i fjalës legjendar është në dy versione:

1. Që ka të bëjë me legjendën, që lidhet me legjendën, i legjendës, që është legjendar...dhe 2. Që është kthyer në legjendë, që është karakteristik për



# për ditëlindjen e Adem Jasharit



legjendar; që bën trimëri të pashoqe, që mbetet i pavdekshëm, madhështor, i jashtëzakonshëm. Hero legjendar. Figurë legjendare. Luftë, epike legjendare. Trimëri legjendare. Duke i dhënë emërtimin "legjendar" u synua të bëhej pikërisht ajo që është dashur: një njeri "që bën trimëri të pashoqe, që mbetet i pavdekshëm, madhështor, i jashtëzakonshëm".

## Kur u shpall Adem Jashari komandant i përgjithshëm legjendar?

Robelli, ndoshta nga padija e ngjarjeve, shkruan se "Pas luftës e quajtën komandant legjendar".... Kur është

shpallur Adem Jashari komandant i përgjithshëm legjendar i UÇK-së?

Këtë e kam treguar në shkrimin tim "Loti në sytë e Rifat Jasharit", kur shkova t'i jap lajmin se është marrë vendimi për shpalljen e Adem Jasharit "komandant i përgjithshëm legjendar i UÇK-së" dhe kërkoja miratimin e tij.

Kur ndodhi kjo?

Adem Jashari nuk është shpallur pas luftës komandant legjendar, por më 5 mars 1999, në përvjetorin e rënies së tij.

Ai nuk është shpallur thjesht "komandant legjendar", por më saktë "komandant i përgjithshëm legjendar", duke nënvizuar përcaktimin "i përgjithshëm".

Ata që më pas hoqën përcak-

timin "i përgjithshëm", kanë mëkatet e tyre ndaj tij dhe figurës së tij.

Shpallja e tij është bërë pikërisht në përkujtimin e parë të rënies së tij, në qytetin e Mynihut, në prani të mijëra vetave, pastaj është bërë publikimi në mediet shqiptare. Të nesërmen lajmi është emetuar në Radiotelevizionin Publik Shqiptar nga drejtori i përgjithshëm i këtij institucioni dhe një njeriu me përkushtim të madh ndaj luftës në Kosovë, pa asnjë përfitim vetjak, Eduar Mazi.

Më 5 mars 1999 askush nuk e ka ditur se në qershor të këtij viti do të ndodhte ditëçlirimi i Kosovës.

Është gjykuar të bëhet në këtë ditë, pasi jo vetëm përkonte me

rënien e familjes Jashari, por edhe me fillimin e ofensivës së re serbe mbi Kosovën, për të nderuar një figurë si ajo dhe për ta rritur ndjenjën atdhetare dhe përgjithësimin e luftës përmes një figure si ajo e Adem Jasharit.

Vetëm nga shtetet perëndimore, në një periudhë shumë të shkurtër, janë kthyer në Kosovë, të organizuar, rreth 9 400 luftëtarë të rinj.

Si u bë publike për herë të parë ditëlindja e Adem Jasharit dhe nga kush?

Por, le t'i kthehemi ditëlindjes së Adem Jasharit, si një datë e rëndësishme historike, edhe nëse ajo nuk do të ishte më 28 nëntor 1955, si ka ndodhur, por në secilën ditë të vitit.

Fakti që një hero kombëtar, jo

një fshatar kryengritës, u lind më 28 nëntor, është parë si një shenjë fatsjellëse dhe si një urë përbashkuese e kombit. Fakti që, po ashtu, njerëzit e të gjitha trevave e ndiejnë njëllot të afërt figurën e tij legjendare është, po ashtu, shpresëdhënëse, në të kundërtën e një psikoze që duan domosdo të krijojë një linjë të përbashkët mendimi beogradas lidhur me luftën dhe figurat e saj. Në këtë linjë e përjashtoj zotin Robelli.

Le të vijmë tek e fundit, por kësaj here më e rëndësishmja: ditëlindja e Adem Jasharit: është 28 nëntori apo 10 tetori i vitit 1955? Me cilën ditëlindje e kanë njohur, ndjekur, gjykuar e dënuar serbët Adem Jasharin dhe a është e vërtetë se vetëm pas luftës po festohej ditëlindja e tij më 28 nëntor?

Çfarë thonë dokumentet e kohës?

Ja një prej tyre:

Më datën 4 tetor 1996 Gjykata Serbe në Kosovë lëshoi aktvendimin mbi zhvillimin e hetimeve kundër 15 qytetarëve të Kosovës, mbi përkatësinë e tyre në një organizatë terroriste.

Gjyqtari hetues i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Danica Marinkoviqi, në lëndën penale të pandehurit Besim Rama etj., për shkak të veprës penale terrorizëm, nga neni 124 i LPJ, lidhur me nenin 19 të LPJ, duke vendosur sipas kërkesës për zbatimin e hetimeve të PPQ në Prishtinë PP. nr. 139-96 nga data 4. X. 1996, merr këtë akt vendim mbi zbatimin e hetimeve kundër:...

1. Besim Rama....

2. Avni Nura...

3. Adem Jashari, i biri i Shabanit, i lindur më 28 nëntor 1955 në Prekazin e Ulët, Komuna e Serbicës, shqiptar, shtetas i RFJ-së, i martuar, bujk, gjendet në arrati...

Gjykata Speciale Serbe duhet ta kishte më mirë se kur ka lindur Adem Jashari për të cilin ka shkruar ditëlindjen 28 nëntor 1955.

Në këtë gjyq, me këtë ditëlindje, Adem Jashari do të dënohej me 20 vjet burgim, aq sa ishte dënimi më i lartë i asaj kohe në Kosovë.

Tani, sipas Robellit, një kolegj i tij, Nexhmedin Spahiu, analist kontrovers dhe gjithnjë në përpjekje të vazhdueshme për denigrimin e UÇK-së, i njëjti që dikur, në qershor 1998, në kulmin e ofensivës serbe, u deklaronte medieve të huaja se në Kosovë janë dy UÇK që po përplasen me njëra-tjetrën, paska zbuluar një ditëlindje tjetër dhe retushimi i historisë duhet të fillojë nga kjo.


Shteti policor serb, Gjykata e Qarkut të Prishtinës, e dënoi Adem Jasharin, lindur më 28 nëntor 1955, me 20 vjet burgim.



**E rrallë**

## Policja ushqen me gjë foshnjën e një gruaje të arrestuar

Ishte roje në spitalin pediatrik "Sor Maria Ludovica" të Buenos Aires kur ka parë një grua, të sapoarrestuar, me djalin gjashtëmuajsh që qante shumë dhe të paushqyer. Celeste Ayala, police, ka marrë në krahë të voglin dhe e ka ushqyer me gjë në korridorin e spitalit. Fotografia e saj tani po bën xhiro nëpër botë.



**FOTO E DITES**



Një qytetar shikon diellin kur lind në Timmendorfer Strand në Gjermani. /AP/

**E jashtëzakonshme**

## Shkencëtarët zbulojnë akull në sipërfaqen e Hënës

Shkencëtarët kanë thënë se kanë të dhëna përfundimtare për shtresa të akullit në sipërfaqen e Hënës. Të dy depozitat janë gjetur në polin verior dhe atë jugor dhe ka mundësi që datojnë nga kohët e lashta. Rezultatet kanë ardhur nga një mision indian, i cili ka ekspoluruar Hënën në



vitet 2008-2009. Detajet e punës janë publikuar në revistën shkencore "Proceedings of the National Academy of Sciences" (PNAS).

**BARSOLETA E DITËS**



Shkon fukaraja me të birin te mjeku:  
- Zotëri doktor, nuk po ha asgjë. As bukë, as sheqer, as pite, as peshk!  
- Po pse bre?  
- Paj... nuk po i kam.



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**


Vetem gjate vikendit në ora 16:00

### "INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird




Në ora 18:20

### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco



Në ora 20:00

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed




Në ora 22:00

### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**  
Sot gjatë gjithë ditës do të mendoni

vetëm për çështje pune dhe financiare. Duhet të mendoni edhe për çështjet e zemrës.



**DEMI**  
Keni rezultate të shkëlqyera në një

projekt që vjen si pasojë e bashkëpunimit shumë të mirë që keni me kolegët tuaj.




**BINJAKËT**  
Kujtimet e ëmbla po ju lezetojnë

ditën sot. Jeni të përkundur nga një ndjenjë kënaqësie që nuk e kuptoni nga vjen.



**GAFORRJA**  
Sot dëshironi të qëndroni të qetë në

ambientin tuaj që ju pëlqen aq shumë. Një ditë jo me ndonjë ngjarje të veçantë për t'u mbajtur mend.



**LUANI**  
Duhet të mbani nën fre krenarinë

tuaj dhe ambicien e tepruar sepse në të shkuarën keni bërë gabime që ju kanë kushtuar shtrenjtë.



**VIRGJËRËSHA**  
I keni pasur çastet tuaja të

lavdisë gjatë paradites së sotme dhe për këtë jeni shumë krenar. Mbrëmja paraqitet e qetë.



**PESHORJA**  
Sot një ditë e mirë për takime pune. Fati

është në anën tuaj dhe çdo gjë do të përfundojë në favorin tuaj.



**AKREPI**  
Sot do të vendosni të kaloni një ditë me miqtë

sepse ju duhet mendimi i tyre për një vendim të rëndësishëm që do të merrni.



**SHIGJETARI**  
Jeni disi të pakënaqur me disa

situata që po ndodhin rreth jush. Do të kërkonti ta gjeni fajtorin, por nuk do të mundni dot.



**BRICJAPI**  
Do t'ju vlerësojnë për aftësitë tuaja

në punë sot dhe vlerësimi do të jetë moral dhe financiar.



**UJORI**  
Sot ngjyra juaj është blu si deti si qielli si

çdo gjë që ju çon larg banales dhe vulgaritetit. Do të ndiheni shumë të lirë.



**PESHQIT**  
Po ju vijnë në mend çaste që

keni shumë dëshirë t'u riktheheni përsëri. Kujtime të bukura po ju shoqërojnë gjatë ditës.









## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:  
044 248 173  
044 200 604  
044 375 333**



## Swifti thyen rekordin personal



**T**aylor Swift e ka thyer rekordin si femra me turneun më të madh në Amerikë, rekord të cilin e ka mbajtur vetë në të kaluarën. Këngëtarja 28-vjeçare momentalisht është duke performuar në kuadër të turneut të saj Reputation Stadium dhe deri më tani ka grumbulluar 191.1 milionë dollarë, shkruan "Billboard".

Ajo edhe më parë e vendosi rekordin për turneun më të madh me të ashtuquajturin 1989, i cili grumbulloi 181.5 milionë dollarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Deri më tani 1.489.904 njerëz kanë paguar për të marrë pjesë në koncertet e saj dhe për të gjithë 27 data të planifikuara janë shitur të gjitha biletat.

## Asia Argento mohon akuzat për sulm seksual



**A**ktorja italiane Asia Argento, udhëheqëse e lëvizjes "MeToo", ka mohuar fuqishëm akuzat për sulm seksual. Në dokumentet ligjore të publikuara nga "New York Times", pretendohet se ajo kishte paguar Jimmy Bennett 380 mijë dollarë pasi ky i fundit e kishte akuzuar se aktorja e ngacmoi

seksualisht kur ishte 17 vjeç. Në një deklaratë Argento ka mohuar tërë përmbajtjen e artikullit të "New York Times". "Kurrë nuk kam pasur lidhje seksuale me Bennettin", ka thënë ajo. Sipas dokumenteve, ngjarja besohet të ketë ndodhur në vitin 2013 në një dhomë hoteli në Kalifornia.



## Kjo është Rita pas çmimit në VMA

**R**ita Ora ka qenë në qendër të vëmendjes së medieve në Nju Jork pas triumfit në MTV Video Music Awards. Këngëtarja nga Kosova atje është fotografuar duke ecur rrugëve të qytetit, për çka portali "justjared" e ka komplimentuar për përzgjedhjen

e veshjes dhe për fytyrën pa grim. Gjatë ndarjes së çmimeve nga MTV për videoklipet e nominuara, Rita ka marrë çmimin e videos më të mirë në kategorinë "Best Dance", duke u bërë shqiptarja e parë që ndonjëherë është kurorëzuar me çmim në këtë ngjarje.

## Post Malone flet pas incidentit me aeroplan

**P**ost Malone ka folur pas incidentit me aeroplanin e vet privat, në veçanti ka reaguar për personat që deshën ta shohin të vdekur. Reperi ishte duke udhëtuar për në Britani për të marrë pjesë në festivalin "Reading" dhe "Leeds", kur dy gomat e përparme të aeroplanit u shpërthyen. Aeroplani bëri ulje emergjente dhe askush nuk u lëndua. Në një shkrim në llogarinë e vet në "Twitter", Post Malone ka falënderuar të gjithë për



lutjet, mirëpo ka thënë se "nuk mund ta besonte se sa njerëz ia uruan vdekjen".





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

TRECIN - AEK LARNACA

1

ATALANTA - FC KOPENHAGEN

GG

APOEL - LOKOMOTIV AST.

1

# Hajdari: Drenica, mësim për Llapin

Fiton Hajdari ka thënë për "Epokën e re" se Drenica i ka dhënë mësim Llapit për ndeshjet e radhës. Ai beson se gabimet si në ndeshjen e parë ndaj kuqezinjve nuk do të përsëriten në të ardhmen. "Në ndeshjen e parë ndodhi më e keqja, pasi humbëm tri pikë si vendës. Nuk e zhvilluam ndeshjen tonë dhe nuk bëmë asgjë çfarë kemi stërvitur dhe kemi bërë shumë gabime. Kjo humbje do të na shërbejë shumë për ndeshjet e radhës për të mirë. Do të mësojmë nga gabimet dhe do të mundohemi që ato mos të përsëriten në të ardhmen", ka thënë Hajdari

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 GUSHT - "Po rikthehem te Llapi me të vetmin qëllim: t'i ndihmoj skuadrës ta fitojë titullin e parë kampion dhe të kalojë në kupat e Evropës. Besoj se të gjithë së bashku do t'i arrijmë objektivat e klubit", kishte qenë deklarata e parë e Fiton Hajdarit me rastin e transferimit të skuadra e Llapit. Mirëpo kjo skuadër në xhiron e parë të edicionit të ri futbollistik dështoi të marrë fitore, pasi humbi si vendës nga Drenica (0-1).

Fiton Hajdari të mërkurën për "Epokën e re" ka treguar arsyen e dështimit në këtë ndeshje, duke thënë se kjo humbje do t'i shërbejë kësaj skuadre si mësim për ndeshjet e tjera. "Në ndeshjen e parë ndodhi më e keqja, pasi humbëm tri pikë si vendës. Nuk e zhvilluam ndeshjen tonë dhe nuk bëmë asgjë çfarë kemi stërvitur dhe kemi bërë shumë gabime. Kjo humbje do të na shërbejë shumë për ndeshjet e radhës për të mirë. Do të mësojmë nga gabimet dhe do të përpiqemi që ato mos të përsëriten në të ardhmen", ka thënë Hajdari.

Futbollisti që luan në repartin e sulmit në afatin kalimtar të verës u transferua nga skuadra e Trepçës '89. Ai foli edhe për ndeshjen e xhiros së dytë në IPKO Superligë ndaj Ballkanit. "Ndeshja ndaj Ballkanit do të jetë shumë e vështirë, por ne jemi duke u përgatitur për këtë përballje dhe mendoj se do të marrim rezultat pozitiv", ka deklaruar Hajdari, i cili ka

Petrit Miftari  
PHOTOGRAPHY

lënë të nënkuptohet se edhe një pikë ndaj Ballkanit do të ishte e mjaftueshme për Llapin.

Skuadra nga Podujeva ka bërë shumë ndryshime para fillimit të kampionatit ku në krye të shtabit teknik u emërua Bylbyl Sokoli, kurse ky klub

transferoi këta futbollistë: Fiton Hajdarin, Bledar Hajdinin, Ahmed Januzin, Bujar Idrizin, Dardan Sekiraqën, Kastriot Selmanin, Arbnor Ramadanin, Behar Maliqin, Ardian Hotin, Alban Rexhepin, Shend Kelmendin dhe Elgant Haxhon.

## SHKURT

## Sot shorti për ligën e femrave në futboll

Sot (e enjte) në orën 11:00 do të bëhet tërheqja e shortit për ligën e femrave (senioret). Federata e Futbollit e Kosovës njofton se të gjitha klubet janë të obliguara t'i dërgojnë përfaqësuesit e tyre për pjesëmarrje në tërheqjen e shortit.

## Henry, trajner i Bordeauxit

Ish-ylli i Arsenalit dhe Barcelonës, Thierry Henry, pritet të jetë trajner i skuadrës së Bordeauxit. Mediet në Francë raportojnë se Henry është pajtuar për ta marrë drejtimin e klubit francez, i cili e ka pezulluar trajnerin Gus Poyet. Henry ka një karrierë fantastike si futbollist, kurse aktualisht është ndihmëstrajner në Kombëtaren e Belgjikës, derisa shumë shpejt pritet të zyrtarizohet në postin e ri.

## Fahro Alihodziq te KB Prishtina

Lojtari me prejardhje boshnjake, i cili mbron ngjyrat e Britanisë së Madhe, Fahro Alihodziq, është transferimi i ri në ekipin e basketbollit të Prishtinës. Qendra 208 cm i gjatë njihet për lojë fizike nën kosh, ku arma e tij më e fortë është mbrojtja, e cila do t'i japë mjaft siguri ekipit. Alihodziq ka qenë pjesë e disa ekipeve, duke filluar nga Amerika, ku ishte pjesë e disa kolegjeve si, Fordham, Southeastern Iowa CC, si dhe UAB. Në kolegje pati paraqitje mjaft të mira. Karrierën si profesionist e nisi në Hungari te dy herë kampioni, Kaposvari. Shumicën e karrierës e kaloi në Greqi te skuadrat Rethymno, Promitheas Patras e Panionis. Një edicion luajti edhe në Estudiantes Concordias të Argjentinës, kurse së fundi mbrojti ngjyrat e skuadrës nga Superliga e Belgjikës, Leuven Bears.

## Reali pritet ta rrëmbejë Mbappen nga PSG-ja

Kylian Mbappe sezonin e kaluar u transferua nga Monaco në Paris Saint Germain në një marrëveshje huazimi me të drejtë blerjeje për 180 milionë euro, shifër të cilën PSG-ja duhet ta paguajë brenda 27 gushtit të këtij viti. Llogaritë janë komplikuar shumë dhe PSG-ja po has probleme me 'fair-play'-n financiar, ndaj mundësitë për ta paguar kartonin e tij po zvogëlohen nga dita në ditë. Këtë situatë po e monitoron me kujdes Reali i Madridit, që është gati të përfitojë dhe të marrë Mbappen për ta zëvendësuar Cristiano Ronaldon.

## Greza: Dua të jem sa më parë gati për Shqipërinë

Tiranë, 22 gusht - Konsiderohej me të drejtë i preferuari i Cristian Panuccit për fazën e sulmit të kuqezinjve, por Eros Greza pësoi një dëmtim që e mbajti për një kohë të gjatë jashtë fushave. Lista e futbollistëve që nuk mund të jetë nën urdhrat e tra-

jnerit italian për ndeshjet e para të Ligës së Kombeve është zgjeruar dhe me siguri Greza do të kthehet pikë referimi, edhe pse ende nuk është në formën e tij më të mirë. Në një intervistë telefonike për "Sport News", Greza tregoi për fazën e gjatë të

rikuperimit si dhe shprehu gatishmërinë për ta dhënë kontributin e tij në takimet e radhës së kuqezinjve. "Tani jam në fazën e rikuperimit dhe kam nisur stërvitjen me ekipin. Dua të jem në formën më të mirë jo vetëm për të ardhur aty, por për të qenë

gati për ndeshjet në shtator. Roshi dhe Sadiku kanë treguar se janë të rëndësishëm dhe më vjen keq që nuk do të jenë për ndeshjet e radhës nga dëmtimi i rëndë, por nëse rikuperohem unë do të bëj maksimumin", ka thënë Greza.





## Ronardo: Dua ta fitoj Ligën e Kampionëve me Juventusin

TORINO, 22 GUSHT - Cristiano Ronaldo ka synime të mëdha me skuadrën e Juventusit. Portugezi ka bërë me dije se synon të triumfojë në Ligën e

Kampionëve. "Dua ta fitoj Ligën e Kampionëve me Juventusin. Do të përqendrohemi te ky objektivi, por pa e pasur fiks. Hap pas hapi do të përpiqemi të

fitojmë dhe më pas do të shohim se deri ku do të shkojmë këtë vit. Nëse nuk e fitojmë sivejt, do ta fitojmë vitin tjetër ose atë tjetrin", ka thënë Ronaldo.

"Objektivi themelor i klubit është ta fitojë kampionatin, Kupën e Italisë dhe të bëj sa më mirë në Ligën e Kampionëve", ka deklaruar Ronaldo.



# Kaka: Dua të bëj më shumë për Milanin



MILAN, 22 GUSHT - Ricardo Kaka është drejt rikthimit te Milani dhe këtë e ka pranuar vetë ylli brazilian në një intervistë të dhënë për mediet italiane. Fituesi i "Topit të Artë" me kuqezinjët e ka mbyllur me futbollin e luajtur, por synon të kthehet me një post drejtues në skuadrën e Gattusos dhe bashkë me Leonardon e Maldinin, të rikthejnë në maja emrin e Milanit.

*Çfarë i ka sjellë Leonardo Milanit?*

**Kaka:** Përvoja, kontaktet me FIFA-n dhe UEFA-n, si dhe me klubet e mëdha. Leo ka bërë gjithçka, ka bredhur botën. Është i zgjuar dhe e njeh mirë artin e komunikimit. E di se si ndërtohet një skuadër e madhe.

*Po Maldini, çfarë mund t'i shtojë më shumë kupolës drejtuese të Milanit?*

**Kaka:** Paolo është historia, fla-

muri. Është një idhull. Në botë, nëse flet për Milanin, flet edhe për Paolon dhe anasjelltas. Paolo është besnikëria. Drejtuesit e sotëm kanë rigjetur ADN-në e Milanit. Leo dhe Paolo janë rikthyer, ndërsa Gattuso qëndroi në bankinë. Rino është nga ata që kanë shumë grintë, shpirtin që nuk dorëzohet kurrë. Kështu ishte edhe kur luante.

*Si ju duket ky Milan?*

**Kaka:** Është një skuadër që po kërkon seriozisht të rimarrë vendin që i takon në futbollin e madh. Nuk duhet ta nënvlerësojnë Evropë Ligën. Kur të eliminohet skuadra të rëndësishme nga Liga e Kampionëve, do të bëhet një turne shumë tërheqës dhe për ta fituar mund të bëhet një objektivi shumë i rëndësishëm.

*Shkuat te Reali i Madridit në vitin 2009, bashkë me*

*Ronaldon. Duke qenë se ke luajtur me të dhe e njeh nga afër, çfarë tipi është?*

**Kaka:** Për futbollin italian është shumë bukur që e ka afruar. Rrit shikueshmërinë, afron sponsorët dhe shton interesimin e medieve nga e gjithë bota. Kampionët e mëdhenj, nëse do të kenë mundësi për t'u transferuar në Serinë A, do të mendohen gjatë. Cristiano sjell gjëra pozitive në sistemin e futbollit italian, jo vetëm tek Juventus.

*Kur do t'ju shohim te Milani?*

**Kaka:** Nuk e kam idenë. Për momentin dua të qëndroj pranë familjes sime në Brazil dhe nuk mund ta imagjinoj një impenjim fiks. Mund të vij në Itali për motive personale, kështu që do të kem mundësi për ta testuar terrenin. Do të jem në "San Siro" si tifoz, por pa dyshim se do të doja të bëj diçka më shumë për Milanin. Është çështje kohe.

## VAR-i edhe në Ligën e Kampionëve

NYON, 22 GUSHT - UEFA synon ta fusë në përdorim VAR-in (Video Assistant Referee) që nga çerekfinalët e këtij sezoni në Ligën e Kampionëve, pas suksesit që kjo teknologji pati në Kupën e Botës në Rusi. Vendimi do të merret në fund të këtij muaji. Bordi drejtues i UEFA-s ka qenë duke kërkuar një mënyrë se si ta fusë këtë teknologji në Ligën e Kampionëve për rishikimin e incidenteve me ndikim në rezul-

tatin e ndeshjeve. Ata kanë ardhur në përfundim se mënyra më e lehtë për ta bërë prezantimin e VAR-it në këtë garë do të jetë nga çerekfinalët.

Komiteti i garave të UEFA-s pritet ta rekomandojë përdorimin e VAR-it në Ligën e Kampionëve javën e ardhshme në Monako, ku do të takohet bordi drejtues. Vendimi përfundimtar do të merret në fund të këtij muaji. Problemi më i madh me të cilin po përballlet

UEFA sa i përket përdorimit të VAR-it ishte sa i përket fuqisë punëtore që kërkohet për t'i vëzhguar tetë ndeshjet që zhvillohen në të njëjtën natë në fazën e grupeve. Për më tepër, disa stadione nuk i kanë pajisjet e nevojshme për këtë teknologji. Për këtë arsye, UEFA pritet ta marrë vendimin që fillimisht VAR-i të përdoret vetëm prej fazës së çerekfinalëve, pasi në këtë fazë luhet vetëm një ndeshje gjatë natës.

## SHKURT

### Serena Williamsi, atletja më e pasur në botë

Tetë nga dhjetë gratë më të pasura atlete janë teniste dhe e para në këtë listë radhitet kampionia e shumëfishtë e Grand Slamit, Serena Williamsi. Williamsi ka fituar 62 mijë dollarë nga çmimet përgjatë vitit që shkoi, ndërsa ka realizuar të hyra prej 18 milionë dollarësh nga bashkëpunimet me kompani të ndryshme. Fitimet e Williamsit siguruan që ajo ta kryesojë listën për të tretin vit me radhë, duke përfituar rreth dy herë më shumë jasthë fushës së tenisit krahasuar me atletet e tjera. Tenistja gjithashtu ishte pjesë e listës së "Forbes"-it për 100 atletet më të paguar në botë. Në muajin qershor lista e "Forbes"-it nuk pati asnjë grua pasi Serena u largua. Boksieri amerikan Floyd Mayweather kryesonte listën, i ndjekur nga futbollistët Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo.

### Bayerni synon transferimin e Dybalas

Kampioni i Gjermanisë, Bayern Munchen, është duke u interesuar për transferimin e lojtarit Paulo Dybala nga Juventus. Lajmi është konfirmuar nga gazeta gjermane "Bild". Këtë lëvizje skuadra e Bayernit po planifikon ta bëjë gjatë afatit kalimtar të dimrit. Një tjetër dëshirë e klubit gjerman është edhe sulmuesi i Atletico Madridit, Antoine Griezmann. Bayerni arriti ta mbajë sulmuesin Robert Lewandowski, i cili pritej t'i bashkohej Real Madridit.

### Koulibaly lavdëron Ancelottin

Mbrojtësi Kalidou Koulibaly e ka lavdëruar trajnerin e ri në skuadrën e Napolit, Carlo Ancelottin. "Shpresoj t'i kënaqim tifozët këtë sezon. Duam ta fitojmë titullin. Ancelotti është ndryshe nga Sarri, dhe nuk kam parë njeri më të përlulur se ai në jetën time", ka thënë Koulibaly.

### Të pathënat e Raikkonenit

Në pritje të përkthimit në gjuhën angleze dhe shpërndarjes në libraritë e mbarë globit, kanë nisur të bëjnë bujë kopjet e para të shpërndara të autobiografisë së Kimi Raikkonenit. Piloti i Ferrarit vendosi të tregojë disa prej sekreteve të tij më intime, si dhe detaje të fshehura për publikun, në librin "Kimi, Tuntematon" (Kimi sekret), një botim që u bë i mundur falë bashkëpunimit me shkrimtarin Hotakainen. Muaj të tërë në krah të pilotit të Ferrarit i shërbyen shkrimtarit nordik për të mbledhur rrëfime unike dhe për të regjistruar detaje interesante të jetës së një piloti, në dukje i akullt, por me shumë çmenduri të provuara. Piloti skandinav i garave spektakolare të Formulës 1 ndalet në librin e tij në problemet me leximin, të folurën, vuan nga astma dhe ra për shumë kohë në vorbullën e rrezikshme të alkoolit, aty ku kërkoi strehim nga stresi i madh. Kimi Raikkoneni rrëfeu gjithashtu se si bëri një garë spektakolare në Çmimin e Madh të Spanjës në vitin 2012. Asokohe arriti të ngjitej në podium pas një feste që kishte zgjatur plot 16 orë. Për të apasionuarit e Formulës 1, libri është një mundësi e artë për ta njohur më mirë pilotin finlandez, që është pjesë e historisë së garave. Këtë fundjavë rikthehet kampionati me Çmimin e Madh të Belgjikës, ndërsa javën e ardhshme garohet në Monza. Pikërisht këtu, Kimi Raikkoneni shpreson se do të vijë edhe konfirmimi për qëndrimin te Ferrari, të paktën edhe një sezon.

### Lewandowski: E mendova largimin nga Bayerni

Robert Lewandowski e ka pranuar se dëshironte të largohej nga Bayern Muncheni për faktin se ndihej i nënvlerësuar nga drejtuesit e klubit. "Në pranverë të gjithë më kritikonin dhe u ndjeva i vetmuar. Më dukej se nuk kisha mbrojtje nga klubi. Nuk shënova në disa ndeshje të rëndësishme dhe papritur të gjithë më sulmuan, por asnjë nga drejtuesit e lartë nuk më doli në mbrojtje. Në atë moment më dukej sikur askush nuk më vlerësonte dhe për këtë arsye mendova lamtumirën", ka thënë Lewandowski për "Sport Bild". "Jam kthyer me zemër dhe kam vënë re që tifozët më duan ende. Nuk do t'i krijoj më probleme klubit. Kontrata me këshilltarin Zahavi nuk lidhet vetëm me transferimin tim gjatë", ka deklaruar sulmuesi polak.





Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria-Vlada-Government  
 Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health  
 Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fund

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës si dhe në mbështetje të nenit 4 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe në bazë të Statutit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor, Fondi i Sigurimit Shëndetësor shpallë këtë Konkurs Publik.

Data e publikimi: 21.08.2018  
 Nr. Referencës: 11/08/2018

## KONKURS

<b>Institucioni:</b>	Fondi i Sigurimit Shëndetësor
<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Udhëheqës i Njësisë së Auditimit të Brendshëm
<b>Paga Bruto:</b>	1,171.18 euro
<b>Kohëzgjatja e Kontratës:</b>	Me kohë të caktuar, me mundësi të vazhdimit
<b>Orari i punës:</b>	40 orë në javë
<b>Raporton:</b>	Drejtorit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor
<b>Periudha provuese</b>	Gjashtë (6) Muaj

### Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Udhëhequnë e gjithmbarshme dhe cakton objektivat e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në përputhje me strategjinë dhe objektivat e institucionit.
- Menaxhon stafin, organizon punën, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore.
- Harton Planin Strategjik, Planin Vjetor, Programet Strategjike-Vjetore të auditimit dhe zhvillimin e burimeve njerëzore
- Përgatit raportet e auditimit
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve si dhe iniciacionin veprimeve korrigjuese aty ku është e nevojshme.
- Përgatit dhe dorëzon raporte të rregullta për të gjitha aktivitetet e auditimit tek udhëheqësi i institucionit dhe Komitetit për Auditim të Brendshëm.
- Siguron zbatimin adekuat dhe respektimin e ligjeve, rregullave, politikave, udhëzimeve dhe doracakëve të përcaktuar
- Aktivitetet i pavarur këshillëdhënës për të ofruar siguri të arsyeshme menaxhmentit për të rritur kapacitetet dhe për të shtuar vlerën e organizatës;
- Përgatit planin për të siguruar zhvillim të vazhdueshëm profesional të stafit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm

**Procedurat e konkurrimit:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kriteret e konkursit

### Shkollimi i kërkuar:

- Diplomë universitare në ekonomik, juridik ose administratë publike.
- Të jetë i certifikuar si auditor i brendshëm

### Aftësia / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e auditimeve;
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
- Shkathësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
- Njohuri të plotë dhe përvojë të ligjeve dhe procedurave përkatëse;
- Shkathësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Minimum pesë (5 vite) përvojë pune profesionale.

### Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Aplikacionin së bashku me CV
- Letër motivuese
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata se kandidati nuk është në procedurë hetimore
- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës

Data e publikimit dhe e mbylljes së konkursit: 21.08.2018 deri 04.09.2018

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren në Divizionin e Burimeve Njerëzore në Fondin e Sigurimit Shëndetësor, dhe dorëzohen në zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore, adresa: Prishtinë, Lakërishtë, Rruga Tirana. Objekti "Beni Dona". Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Informacionet shtesë mund të mirën në këtë nr tel: 038 20080705

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Petrit Bruqi  
 Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria-Vlada-Government  
 Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health  
 Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fund

Na osnovu člana 8 Zakona br. 03/L-212 o radu, kao i u skladu sa članom 4 i članom 5 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju procedura konkurisanja u javnom sektoru, kao i na osnovu Statuta Fonda za zdravstveno osiguranje, Fond za zdravstveno osiguranje objavljuje javni konkurs.

Datum objavljivanja: 21.08.2018  
 Br. referencë: 11/08/2018

## KONKURS

<b>Institucija:</b>	Fond za zdravstveno osiguranje
<b>Naziv radnog mesta:</b>	Rukovodilac Jedinice za unutrašnju reviziju
<b>Bruto plata:</b>	1,171.18 evra
<b>Vreme trajanja ugovora:</b>	na određeno vreme, uz mogućnost produženja
<b>Radno vreme:</b>	40 sati nedeljno
<b>Izveštava:</b>	Direktoru Fonda za zdravstveno osiguranje
<b>Probni period</b>	Šest (6) meseci

### Dužnosti i odgovornosti:

- Rukovodi opštim poslovima o određuje ciljeve Jedinice za unutrašnju reviziju u skladu sa strategijom o ciljevima institucije.
- Menadžira osobljem, organizuje rad, daje uputstva i prati rad osoblja, kako bi pružao kvalitetne proizvode i usluge.
- Sastavlja Strateški plan, Godišnji plan, strateške godišnje programe revizije i razvoja ljudskih resursa.
- Priprema izveštaje o reviziji
- Prati sprovođenje preporuka, inicira popravne postupke, tamo gde je to neophodno.
- Priprema i prodaje redovne izveštaje za sve aktivnosti revizije kod rukovodioca institucije u Komitetu za unutrašnju reviziju.
- Obezbeduje adekvatno sprovođenje i poštovanje određenih zakona, pravila, politika, uputstava i priručnika.
- Nezavisne savetodavne aktivnosti kako bi pružao obrazloženu bezbednost menadžmentu, kako bi povećao kapacitet i vrednost organizacije;
- Priprema plan kako bi obezbedio konstantan stručni razvoj osoblja Jedinice za unutrašnju reviziju.

**Postupak konkurisanja:** Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate, koji ispunjavaju uslove konkursa

### Traženo školovanje:

- Univerzitetska diploma sa ekonomskog, pravnog fakulteta ili polja javne uprave.
- Da bude certifikovan kao unutrašnji revizor.

### Sposobnosti/ radno iskustvo i ostali traženi atributi:

- Supstancijalna znanja i iskustva na polju revizija;
- Sposobnost komuniciranja, pregovaranja i ubeđivanja u upravljanju;
- Sposobnost u određivanju ciljeva, planiranju posla i analizi;
- Potpuna znanja i iskustva sa zakonima i određenim procedurama;
- Sposobnost rukovođenja i organizovanja tima, sposobnost upravljanja timom ili radnom grupom;
- Sposobnost rada na kompjuterskim aplikacijama i programima (Word, Excel, Power Point, Access);
- Minimum pet (5 godina) stručnog iskustva.

### Kandidati treba da predaju sledeća dokumenta:

- Prijavu zajedno sa CV-om
- Motivaciono pismo
- Dokaze o školovanju, radnom iskustvu
- Dokaze iz suda da kandidat nije pod istražnim postupkom
- Kopiju lične karte ili pasoša

Datum objavljivanja i zatvaranja: 21.08.2018 do 04.09.2018

**Podnošenje zahteva:** Prijave treba uzeti u Diviziji za ljudske resurse pri Fondu za zdravstveno osiguranje i da se predaju u kancelariji Divizije za ljudske resurse, adresa: Priština, Kupusište, ul. Tirana. Objekat „Beni Dona“. U prijavi treba jasno da se navede naziv radnog mesta i broj reference. Dodatne informacije se mogu dobiti na br. telefona: 038 20080705

Prijave koje su poslate nakon datuma zatvaranja konkursa ili koje su nepotpune, neće biti prihvaćene.

Petrit Bruqi  
 Rukovodilac divizije za ljudske resurse





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government  
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health  
Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fond

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës si dhe në mbështetje të neni 4 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ(MPMS) Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe në bazë të Statutit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, Fondi i Sigurimit Shëndetësor shpallë këtë Konkurs Publik.

Data e publikimi: 21.08.2018  
Nr. Referencës: 12/08/2018

## KONKURS

Institucioni:	Fondi i Sigurimit Shëndetësor
Titulli i vendit të punës:	Vozitës
Koficienti:	6
Nëpunësi mbikëqyrës:	Drejtori i Fondit Sigurimit Shëndetësor
Kohëzgjatja e Kontratës	Me kohë të caktuar, me mundësi të vazhdimit
Orari i punës:	40 orë në javë (orar të plotë)
Periudha provuese	Gjasat (6) Muaj

### Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Zbaton Udhëzimin për përdorimin e automjeteve të FSSH-së
- Zbaton Porosit për Bartjen e Personelit të FSSH-së, për udhëtime zyrtare, për destinime të caktuara dhe anasjelltas
- Është përgjegjës për mirëmbajtjen e përditshme të automjetit të caktuar
- Kujdeset për pajisjet speciale të automjetit
- Bënë kontrollin e vajit, ujit, baterisë dhe gomave të automjetit, me rregull lajmëron zyrtarin e logjistikës për gjendjen e automjeteve
- Përgatit raporte për ndeshje komunikacioni nëse ndodhin dhe çdo gjë që ka të bëjë me automjetin
- Obligohet të përcjell shpenzimet e derivateve dhe shpenzimet tjera, dorëzimi i kopjeve të faturave për derivate, servisim, larjen e automjetit e shpenzimeve tjera.
- Kryen edhe punë të tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës, të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Procedurat e konkurrimit:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotëson kriteret e konkursit.

**Shkollimi i kërkuar:** Shkolla e mesme

### Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkojnë:

- Së paku 1 (një) vite përvojë pune të dëshmuar me dokumente;
- Te këtë leje valide për vozitje kategorija B e detyrueshme
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme
- Krijimi i marrëdhënieve të mira ndër-personale;
- Aftësitë e mira analitike dhe propozime për vendosje të çështjeve;
- Njohja e mirë e punës me kompjuter (Word, Excel, PowerPoint, Access)
- Njohja e gjuhës angleze, përparësi;

### Kandidatet duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Aplikacionin së bashku me CV
- Letër motivuese
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata se kandidati nuk është në procedurë hetimore
- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës

Data e publikimit dhe e mbylljes së konkursit: 21.08.2018 deri 04.09.2018

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren në Divizionin e Burimeve Njerëzore në Fondin e Sigurimit Shëndetësor dhe dorëzohen në zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore zyra nr.13, adresa: Prishtinë, Lakërishtë, Rruga Tirana. Objekti " Beni Dona". Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Informacionet shtesë mund të mirë në këtë nr tel: 038 20080705

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Petrit Bruqi  
Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government  
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health  
Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fond

Na osnovu člana 8 Zakona Br. 03/L-212 o radu i u skladu sa članom 4 i članom 5 Administrativnog uputstva (MRSZ) Br. 07/2017 o regulisanju procedura konkursa u javnom sektoru, kao i na osnovu Statuta Fonda za zdravstveno osiguranje, Fond za zdravstveno osiguranje objavljuje javni konkurs.

Datum objavljivanja: 21.08.2018  
Br. reference: 12/08/2018

## KONKURS

Institucija:	Fond za zdravstveno osiguranje
Naziv radnog mesta:	Vozač
Koeficijent:	6
Nadzornik:	Dircktoru Fonda za zdravstveno osiguranje
Trajanje ugovora	Na određeno vreme uz mogućnost produženja
Radno vreme:	40 sati nedeljno (puno radno vreme)
Probni period	Šest (6) meseci

### Dužnosti i odgovornosti:

- Sprovodi Uputstvo o korišćenju vozila FZO-a
- Prevozi osoblje FZO-a na službenim putovanjima do određenih destinacija i vraća ih nazad
- Odgovoran je za svakodnevno održavanje određenog vozila
- Stara se o specijalnoj opremi vozila
- Kontroliše ulje i vodu, akumulator i gume na vozilu i redovno javlja službeniku logistike o stanju automobila
- Priprema izveštaje o saobraćajnim nesrećama, ukoliko se dogode i sve što je povezano sa vozilom
- Obavezan je da prati troškove derivata i ostale troškove, predaje kopije računa za derivate, servisiranje, pranje vozila i za ostale troškove.
- Vrši i druge poslove u skladu sa ciljem radnog mesta koji se od njega mogu zatražiti s vremena na vreme od strane nadzornika.

**Uslovi za učestvovanje u regrutaciji:** Pravo na prijavljivanje imaju svi odrasli građani Republike Kosovo, koji su u potpunosti sposobni da deluju, koji su završili adekvatno školovanje i imaju profesionalnu sposobnost da izvrše dužnosti.

**Postupak konkurisanja:** Konkurisanje je otvoreno za sve kandidate koji su zainteresovani i koji ispunjuju kriterijume konkursa.

**Traženo obrazovanje:** Srednja škola

### Sposobnosti/ iskustvo i ostali atributi koji se traže:

- Najmanje 1 (jedna) godina radnog iskustva na sličnom poslu koje je dokumentovano;
- Da ima važeću vozačku dozvolu B kategorije obavezno, C kategorija je poželjna;
- Poznavanje primenjivih zakona i uredbi;
- Stvaranje dobrih međuljudskih odnosa;
- Dobre analitičke sposobnosti i predlozi za odlučivanje;
- Dobro poznavanje rada na kompjuteru (Word, Excel, PowerPoint, Access)
- Poznavanje engleskog jezika je prednost;

### Kandidati treba da predaju sledeća dokumenta:

- Prijavu zajedno sa CV-om
- Motivaciono pismo
- Dokaze o školovanju, radnom iskustvu
- Dokaze iz suda da kandidat nije pod istražnim postupkom
- Kopiju lične karte ili pasoša


Datum objavljivanja i zatvaranja konkursa: 21.08.2018 do 04.09.2018

**Podnošenje zahteva:** Prijave se preuzimaju u Diviziji za ljudske resurse u Fondu za zdravstveno osiguranje i predaju se u kancelariji Divizije za ljudske resurse, kancelarija br. 13, na adresi: Prishtina, Kupusište, Ul. Tirana, objekat „Beni Dona“. U prijavi treba da se jasno navede naziv radnog mesta i broj reference. Dodatne informacije se mogu dobiti na ovaj br. telefona: 038 20080705

Prijave poslate nakon datuma zatvaranja konkursa i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Petrit Bruqi  
Rukovodilac Divizije za ljudske resurse





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo  
Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtorija për Arsim  
Odeljenje za Obrazovanje  
Department for Education

Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në dërgimin Administrativ Nr.27/13 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës Nxënës/Drejtor/Komuna e Arsimit në Rahovec shpall:

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtorija për Arsim  
Odeljenje za Obrazovanje

# KONKURS

Nr. I prot. 223 Mb. 20.08.2018  
Br. prot. 13 Dk. 20.08.2018

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLAT E MESME TË LARTA TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN SHKOLLOR 2018/2019 (afati i gushtit)

## 1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollës profesionale, për vitin shkollor 2018/19, mund të konkurojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.  
Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostifikimin e dëftësive në MASHT dhe pastaj të konkurojnë për regjistrim.

## 2. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Nxënësit për të konkuruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe në shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:  
Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkuron)  
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe  
Certifikatën e lindjes.

## 1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2018/2019, bëhet me datat 20,22 dhe 23 gusht 2018, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 27.08.2018.  
Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës 28.08.2018.  
Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

## A. Kriteret për regjistrim

Kushtet dhe kriteret për regjistrim në klasat e X-ta në shkollat e mesme të komunës së Rahovecit i gjeni në shkollat ku dëshironi të regjistroheni

### PLANIFIKIMI I REGJISTRIMIT TË NXËNËSVE NË KLASAT (X-të) PËR VITIN SHKOLLOR 2017/18, AFATI I QERSHORIT

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësejtë nr. i nxënësve
1	SHML"Xhelal Hajda-Toni"	Rahovec	Gjinnazi i Shkencave Natyrore	3	32	79
			Gjinnazi i Shkencave Shoqërore	3	32	84
			<b>Gjithësejtë:</b>	<b>6</b>		<b>163</b>

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësejtë nr. i nxënësve
2	SHML"Ukshin Hoti"	Krushë e Madhe	Gjinnazi i Shkencave Natyrore	1	32	36
			Gjinnazi i Shkencave Shoqërore	1	32	37
			Makineri: Automekanik	1	28	26
			<b>Gjithësejtë</b>	<b>3</b>		<b>99</b>

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësejtë nr. i nxënësve
3	SHML"12 Maji"	Ratoc	Gjinnazi i Shkencave Natyrore	2	32	70
			Gjinnazi i Shkencave Shoqërore	2	32	48
			Bujqësi Hortikulturë	1	28	28
			Makineri: Automekanik	1	28	28
			<b>Gjithësejtë</b>	<b>6</b>		<b>174</b>

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësejtë nr. i nxënësve
4	SHMLP"Selajdin Mullaabazi-Mici"	Rahovec	<b>Ekonomi:</b> Kontabilitet 1 Tregëti me shumicë e pakicë -1	2	28	35
			<b>Juridik:</b> Asistent Juridiku 1	2	28	31
			Asistent i Administratës 1			
			<b>Hoteleri:</b> Asistent Restoranti 1	1	28	27
			<b>Makineri:</b> Metalpunues 1	1	28	13
			<b>Bujqësi:</b> Agrobiznesi 1	1	28	28
			<b>Teknologji Ushqimore:</b> Teknologji Ushqimore 1 Përpunim i frutave dhe perimeve 1	2	28	54
			<b>Ndërtimtari:</b> Gjeodezi 1	1	28	27
			<b>Elektro;</b> Informatikë 1	1	28	18
			<b>Gjithësejtë:</b>	<b>12</b>		<b>264</b>

<b>Gjithësejtë për komunën e Rahovecit</b>	<b>27</b>	<b>700</b>
--	-----------	------------

Rahovec më,  
20.08.2018



Avni Morina, Drejtor

*(Signature)*

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Omer Avdija shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- Afrim Ukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Deshmoret e Kabashit" Korishë
- Petrit Halitjaha shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren
- Sejria Kalajdzini shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Svetlost" Manastirica.
- Lëshoj banesën me qira. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë, në sheshin "Zahir Pajaziti". Banesa është e mobiluar dhe është me nxemje qendrore dhe ka 70 m2. Çmimi sipas marrëveshjes. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-171-328.
- Lëshoj banesa me qira afër Eulex-it, ish Farmedi, në lagje të spitalit, banesa është e lirë që nga data 01.08.2018. Banesat janë të ndërtuar nga kompania "Cima Contrekshen" njëra banesë ka 112 metër katror ndërsa tjetra 85 metër katror. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 044-923-527 dhe 044-402-679.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira për një person te huaj, Banesa duhet te jete jo shumë larg qendrës, mundësisht tek "Qafa" ose "Tophane" Duhet te ketë dy dhoma gjumi, te jete e mobiluar bukur. Çmimi deri 300 euro. Për info: Tel 049-472-770
- Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perlleshi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151
- Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbropa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## NJOFTIM

Të gjithë investitorët potencial që planifikojnë të ofertojnë në

# Shitjen 40

të aseteve të ndërmarrjeve në Likuidim, njoftohen se dita e dorëzimit dhe hapja e ofertave është:  
e hënë **03 shtator 2018**, prej orës **10:00 - 12:00**, në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, Prishtinë

Njësia nr.01-Agrokultura Toka në Stançiq (Lot B)	Njësia nr.48-Toka Bujqësore në Jashanicë
Njësia nr.02-Pasuria Bujqësore Toka në Prelez i Muhaxhereve (Lot B)	Njësia nr.49-KB Bec Prona në Lipovec
Njësia nr.03-KB 1Maji Depoja në Stanishor	Njësia nr.50-KB Bistrica Ngastra 59-1 në Drenoc
Njësia nr.04-Morava Partesh Toka në Cërnice (Lot B)	Njësia nr.51-KB Istog Tokë Bujqësore në Istog
Njësia nr.05-KB Komogllava Objekti në Komogllavë	Njësia nr.52-KB Kooperimi Toka në Vitomiricë
Njësia nr.06-Pasuria Bujqësore Toka në Kosinë (Lot C)	Njësia nr.53- KB Shtupel Tokë Bujqësore Kërrnicë 3
Njësia nr.07-Pasuria Bujqësore Toka në Rahovicë (Lot E)	Njësia nr.54-Flora Tokë Bujqësore Metehi
Njësia nr.08-Agrokultura Toka në Gjilan (Lot L)	Njësia nr.55-KB Liria Tokë Bujqësore Bërnice e Poshtme II
Njësia nr.09-Pasuria Bujqësore Toka në Pojatë (Lot B)	Njësia nr.56-KB Liria Tokë Bujqësore Bërnice e Poshtme III
Njësia nr.10-Pasuria Bujqësore Toka në Rahovicë (Lot D)	Njësia nr.57-Ratar Tokë Bujqësore Çagllavicë I
Njësia nr.11-Agrokultura Toka ne Malishevë (Lot A)	Njësia nr.58-Ratar Tokë Bujqësore Çagllavicë II
Njësia nr.12- Agromorava Toka ne Tankosic (Lot A)	Njësia nr.59-KB Shtime Tokë Bujqësore Rashincë II
Njësia nr.13-Agrokultura Toka bujqësore Lushtë 3	Njësia nr.61-KHT Kosova Toka Mazgit
Njësia nr.14-Çyçavica Vetëshërbimi 3304 në Prelluzhë	Njësia nr.62-KB Liria Tokë Bujqësore Bërnice e Poshtme I
Njësia nr.15-Univerzal Lokali dhe toka ndërtimore në Dren	Njësia nr.63-KB Liria Tokë Bujqësore Breznicë I
Njësia nr.16-KB Lepasaviq Parcelat në ZK Dubrava	Njësia nr.64-KB Liria Tokë Bujqësore Breznicë II
Njësia nr.17-KB Lepasaviq Toka në Sllatinë	Njësia nr.65-KB Liria Tokë Bujqësore Breznicë III
Njësia nr.18-KB Lepasaviq Toka në Vuçe	Njësia nr.66-KB Liria Tokë Bujqësore Breznicë IV
Njësia nr.19-Produkti Toka në Mikushnicë	Njësia nr.67-KB Liria Tokë Bujqësore Breznicë V
Njësia nr.20-Produkt Parcela 00139-0 në Çitak	Njësia nr.68-KB Liria Tokë Bujqësore Breznicë VI
Njësia nr.21-Produkt Toka në Makermal	Njësia nr.70-Urata Lokali nr. 98
Njësia nr.23-Elan Parcelat 00176-0 dhe 00177-0 ZK Bivolak	Njësia nr.71-Gërmia Shitorja nr.123
Njësia nr.24-NSH Lux Lokali Afarist Rudar	Njësia nr.72-KB Drita Tokë Bujqësore Hërticë
Njësia nr.25-NSH Lux Lokal Mishtorja 3 (Govedji But)	Njësia nr.73-KB Drita Tokë Bujqësore Balloc IV
Njësia nr.26-Produkti Toka në Brojë 3	Njësia nr.74-KB Flora Tokë Bujqësore Revuq I
Njësia nr.27-Produkti Toka në Brojë 4	Njësia nr.75-KB Drita Tokë Bujqësore Surkish I
Njësia nr.28-KB Prelluzha Parcela 00290-0	Njësia nr.76-NSH Lavërtari-Blegtori - Tokë Bujqësore në Lubizhdë 9
Njësia nr.29-KB Prelluzha Ngastrat 0150-0, 0151-0 dhe 0159-0	Njësia nr.77-NSH Lavërtari-Blegtori - Tokë Bujqësore në Trepeticë 1
Njësia nr.30- KB Prelluzha Ngastra 0118-0	Njësia nr.79-NBI Rahoveci Prona në Retijë 4
Njësia nr.31-Produkti Toka Vitak	Njësia nr.80-NBI Rahoveci Prona në Retijë 6
Njësia nr.32-Produkti Toka Klinë e Epërme 2	Njësia nr.81-NBI Rahoveci Prona në Retijë 7
Njësia nr.33-Produkti Toka në Prellovc	Njësia nr.82-NSH Zadruga Shtërpcë - Tokë bujqësore në Biti të Epërme 3
Njësia nr.34-Elan Toka në Resnik	Njësia nr.84-NSH Zadruga Shtërpcë- Tokë bujqësore Biti e Epërme 5
Njësia nr.35-NSHBQ Drenica Toka në Polluzhë parcela 54-0	Njësia nr.85-Shitorja në fshatin Mlikë
Njësia nr.36-NSHBQ Drenica Toka në Polluzhë parcela 28-0	Njësia nr.87-NBI Rahoveci Prona në Xërxe 1
Njësia nr.37-NSHBQ Drenica Toka në Gllanaselë nr.1	Njësia nr.88-NBI Rahoveci Prona në Drenoc 4
Njësia nr.38-NSH Apiko Toka në Baballoq	Njësia nr.89-NBI Rahoveci Prona në Drenoc 5
Njësia nr.39-KB Bec- Parcelat nr. 1076, 1079, 1080 në Bec	Njësia nr.90-DP Zadruga Shtërpcë - Tokë bujqësore Vrbeshticë 3
Njësia nr.40-NSH Ereniku PP-Toka në Qabrat	Njësia nr.91-NBI Rahoveci Prona në Hoqë të Vogël 3
Njësia nr.41-KB Liria Toka Bujqësore në Berkovë	Njësia nr.92-NBI Rahoveci Prona në Hoqë të Vogël 4
Njësia nr.42-NPB Malishgani-Toka bujqësore në Zllakuqan	Njësia nr.93-NBI Suhareka Toka bujqësore në Gjinoc 2
